



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 90

Tiranë – E martë, 2 qershor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 25.5.2015	4739
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 25.5.2015	4746
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 32, datë 25.5.2015	4755
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 25.5.2015	4759
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 29.5.2015	4763

Me objekt: - Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

- Shfuqizimi i vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj”;

- Shfuqizimi i vendimit të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e raportit të komisionit hetimor të ngritur me vendimin nr. 70/2014 “Për hetimin e kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi””;

- Shfuqizimi i vendimit të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj”.

-Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të tri vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të datës 23.10.2014, të kundërshtuara për konflikt kompetencash kushtetuese, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për këtë kërkesë.....



VENDIM
Nr. 30, datë 25.5.2015
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare blerina (çinari) basha, në datën 17.02.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr. 66/33 akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, Avokati i Popullit, përfaqësuar në gjykim nga zoti Hajredin Hysa.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë. Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga zonja Lorana Kasapi.

Shoqata Shqiptare e Bankave, përfaqësuar në gjykim nga avokat Envi Hicka.

OBJEKTI: Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën i fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile “Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d”, 145/2 dhe 134/1, shkronja “dh”; nenet 42, 17 dhe 18 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 68 dhe 70 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Bashkim Dedja, shqyrtoi kërkesat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe të Avokatit të Popullit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe parashtrimet e

subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave, Shoqata Shqiptare e Bankave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (gjykata referuese) ka marrë në shqyrtim çështjen me objekt:

“1. Anulim i vendimeve përmbartimore “Vendim për shpallje ankandi”, me nr. 1229 prot, datë 17.04.2014 dhe nr. 1230, datë 17.04.2014 për disa pasuri të paluajtshme. 2. Pezullim veprimeve përmbartimore të mëtejshme, konkretisht shitje e sendit në ankand dhe veprime të tjera vijuese të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.”.

2. Gjatë gjykimit të kësaj çështje, gjykata referuese krijoi dyshimin se fjalia e dytë e paragrafit të pestë të nenit 610, të Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja), i ndryshuar me ligjin nr. 122, datë 18.04.2013, bie në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo gjykatë, me vendimin e ndërmjetëm nr. 14, datë 02.09.2014, ka vendosur pezullimin e çështjes dhe i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë papajtueshmërinë me nenet 4, 17, 41 dhe 42 të Kushtetutës të fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610, të KPC-së, sipas së cilës: *“Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimi e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet si e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit”.*

3. Institucioni i Avokatit të Popullit (AP-ja), në procesin e shqyrtimit administrativ të çështjes së prezantuar prej shtetasit K.B., ka vlerësuar se parashikimi i sanksionuar në nenin 45 të ligjit nr. 122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit: *“Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbartuesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit”.* është në kundërshtim me procesin e rregullt ligjor, sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin



6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe me parimin e barazisë para ligjit, sipas nenit 18 të Kushtetutës. Për këtë arsye i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizim të kësaj dispozite ligjore.

4. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese në datën 20.11.2014 vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare, si dhe bashkimin e çështjeve me kërkuar respektivë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Avokatin e Popullit, në bazë të nenit 1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 158/2, §10 të KPC-së. Gjithashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve, mbi kërkesën e datës 23.01.2015 të Shoqatës Shqiptare të Bankave për pjesëmarrje në gjykimin kushtetues si subjekt i interesuar, vendosi pranimin e kërkesës së këtij subjekti.

II

5. **Kërkuesi, gjykata referuese**, ka pretenduar se neni i sipërcituar bie ndesh me nenet 4, 17, 41 dhe 42 të Kushtetutës, me argumentet e mëposhtme:

5.1 Pezullimi i ekzekutimit është një masë paraprake, e cila synon të ngrijë procedurat e ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim garantimin e të drejtave të debitorit. Nëpërmjet pezullimit synohet të balancohet, sa është e mundur, pozita e pafavorshme e debitorit si pasojë e kufizimit të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Caktimi te neni 610 i KPC-së i afatit 20-ditor, vetëm për rastet e titujve ekzekutivë që rrjedhin nga aktet e dhënies së kredive nga institute bankare ose jobankare, ka sjellë regres në mbrojtjen e të drejtave të debitorit, pasi atij nuk i sigurohet mbrojtje efektive dhe i është ashpërsuar kufizimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor në mënyrë të panevojshme.

5.2 Neni 610 i KPC-së, duke përcaktuar rënien e masës së pezullimit pas kalimit të 20 ditëve, nuk ofron një mjet efektiv mbrojtjeje sikundër do të ishte parashikimi: masa e pezullimit qëndron në fuqi deri sa gjykata vendos pranimin e padisë. Kufizimi do të ishte proporcional nëse mjeti që do të ofronte legjislacioni do të ishte i tillë që ndërsa, nga njëra anë, garantonte efektivitetin dhe shpejtësinë e procesit gjyqësor, nga ana tjetër, ofronte mbrojtje të përshtatshme për debitorin me

qëllim që të mos i cenoheshin të drejtat e pronës në një procedurë ekzekutimi.

5.3 Debitori, në çdo rast, edhe kur padia e tij për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore do të pranohej nga gjykata, do të ndodhej përballë zhveshjes nga e drejta pronësisë mbi sendet, pasi procesi i ekzekutimit të detyrueshëm do të kishte përfunduar dhe persona të tjerë (kreditori) do të ishin bërë pronarë mbi sendin ose mbi shumën e parave.

5.4 Dispozita është miratuar në shkelje të procesit të rregullt legjislativ, pasi nga procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të Ligjeve konstatohet se në seanca dëgjimore si grupe interesi janë thirrur vetëm përfaqësues të bankave dhe jo shoqata të konsumatorëve, bizneseve apo përfaqësues të individëve, edhe pse prekeshin drejtpërdrejt interesat e tyre. Për këtë arsye është cenuar procesi legjislativ, për rrjedhojë edhe shteti i së drejtës.

6. **Kërkuesi, Avokati i Popullit**, ka pretenduar shkelje të neneve 42, 17 dhe 18 të Kushtetutës, duke argumentuar se:

6.1. Masa e sigurimit të padisë për pezullimin e veprimeve përmbarimore në rastin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, akt dhënie kredie, bie pas kalimit të afatit prej 20 ditësh nga vendosja, që passjell zhvillimin e procedurës së gjykimit në cenim të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

6.2. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kufizimi i vendosur në nenin 610 të KPC-së, fjalja e dytë, paragrafi i pestë, në lidhje me rënien e masës së pezullimit pas 20 ditëve, kur ekzekutimi është akt kredie bankare ose nga institucione financiare, do të justifikohet në rast se do t'i shërbente një interesi publik të gjerë dhe jo vetëm disa subjekte kredidhënëse, siç parashikon dispozita ligjore në fjalë.

6.3. Kufizimi i rënies së masës së pezullimit të veprimeve përmbarimore vetëm në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e aktit të dhënies së kredisë dhe jo për gjitha llojet e titujve ekzekutivë, shkel të drejtën e zhvillimit të procesit të ekzekutimit për të gjitha llojet e titujve ekzekutivë sipas të njëjtës procedurë.

7. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar se:

7.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi nuk ka paraqitur arsye serioze për



antikushtetutshmëri të fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610 të kundërshtuar.

7.2 Gjykata nuk ka hetuar nëse ka pasur norma të tjera për zgjidhjen e çështjes dhe nuk ka argumentuar si ka arritur në konkluzionin që vetëm neni 610 i KPC-së i duhet asaj për zgjidhjen e çështjes në themel. Kjo gjykatë ka pasur në dispozicion të gjitha dispozitat e KPC-së që rregullojnë gjykimin e kërkimeve me objekt “Kundërshtimin e veprimeve përmbareme” për ta zgjidhur çështjen në themel.

7.3 Gjykata nuk ka bërë përpjekje për interpretim pajtues të normës me parimet kushtetuese.

7.4 Premisa mbi të cilën është nisur gjykata referuese se masa e pezullimit me afat të caktuar shkel të drejtat e debitorit, është e gabuar, pasi të gjitha dispozitat procedurale të KPC-së, në harmoni mes tyre, garantojnë një proces të rregullt ligjor për debitorin.

7.5 Marrja e masës së pezullimit nuk është detyrim për gjykatën dhe për më tepër nuk është e drejtë e padiskutueshme e debitorit.

7.6 Afati 20-ditor, si afat gjatë të cilit do të qëndrojë në fuqi masa e pezullimit, është afat i arsyeshëm dhe i arritshëm për gjykatat, në mënyrë që debitorin të jetë i garantuar gjatë procesit gjyqësor.

7.7 Kundërshtimet e gjykatës referuese nuk janë të orientuara drejt antikushtetutshmërisë së normës për shkak të afatit të kufizuar, por drejt mosrespektimit nga gjykata të normave rregulluese procedurale në gjykimin e padive me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbareme.

7.8 Edhe duke e marrë të mirëqenë se ka cenim të të drejtave të debitorit, kjo dispozitë është në proporcion me qëllimin e ligjvënësimit për mbrojtjen e sistemit bankar si çështje me interes publik.

8. Subjekti i interesuar, Shoqata Shqiptare e Bankave, ka prapësuar se:

8.1. Gjykata referuese nuk ka paraqitur argument se pse zgjidhja e çështjes nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi i normës në Gjykatën Kushtetuese. Ajo ka pasur detyrimin ta zgjidhte çështjen brenda 20 ditëve, detyrim që e ka shmangur pa e argumentuar pse.

8.2 Avokati i Popullit nuk legjitimohet, pasi nuk është në filozofinë dhe funksionet e këtij institucioni që të mbrojë të drejtat e individëve nga ligje që lidhin individët me procese gjyqësore para

gjykatave, por me ligje që lidhin individët me veprimet e administratës publike. Interesi i këtij institucioni nuk është i sigurt, duke qenë se nuk provon që të drejtat e rregulluara nga neni 610 i KPC-së kanë qenë objekt i veprimtarisë së tij konkrete. Po ashtu ky institucion nuk ka interes, pasi ai nuk mund të mbrojë të drejtat e individëve në procese gjyqësore civile para gjykatës, pasi është gjykata autoriteti i vetëm që garanton barazinë e palëve dhe të drejtat procedurale.

8.3. Në gjykimet me objekt kundërshtimi veprimet përmbareme, gjykata nuk gjykon thelbin e marrëdhënies juridiko-civile, por vetëm faktin nëse veprimet e përmbaremit janë kryer ose jo në përputhje me ligjin. Prandaj edhe afati 20-ditor për këtë lloj gjykimi është vendosur me synim shmangien e vonesave në këtë fazë të ekzekutimit.

8.4. Edhe pse në dukje ka një kufizim të një lloji të veçantë, që është ai i mospezullimit të ekzekutimit të një kredie bankare për më shumë se 20 ditë, gjë e cila nuk ndodh kur në ekzekutim janë tituj të tjerë ekzekutivë, ky kufizim është bërë për interes publik dhe nuk prek vetë thelbin e së drejtës.

8.5. E drejta e pronës, si e drejtë substanciale e individit, nuk preket gjatë këtij procesi gjyqësor, ku marrëdhënia kontraktuale mes palëve tashmë është vendosur dhe është në proces ekzekutimi të detyrueshëm, si rrjedhojë e mospërmbushjes së detyrimit me faj të debitorit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata çmon të shprehet veç e veç në lidhje me legjitimitimin e kërkuesve, si subjekte për të cilat Kushtetuta ka parashikuar kritere të ndryshme legjitimimi për të iniciuar kontrollin e ligjeve të vlerësuar si të papajtueshme me Kushtetutën.

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

10. Gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nëse plotëson kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Neni 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u njeh të drejtën gjyqësore që në çdo fazë të gjykimin, kur ata çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës



Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve të realizuar nga Gjykata Kushtetuese, por që për iniciues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm, të cilat pezullojnë gjykimin kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore ende të pazgjidhur, përfundimi i së cilës varet nga ligji konkret, çmojnë se ligji nuk është i pajtueshëm me Kushtetutën.

11. Gjykata në vazhdimësi ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të parashtrijë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7 datë 16.02.2015; nr. 39 datë 30.06.2014; nr. 7, datë 27.02.2013; nr. 30, datë 17.06. 2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata referuese ngre pretendime në lidhje me dispozitën objekt gjykimi, që parashikon pezullimin e ekzekutimit si një masë paraprake dhe që synon të ndalojë procedurat e ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim garantimin e të drejtave të debitorit. Sipas gjykatës referuese, afati 20–ditor, si afat i masës së pezullimit të ekzekutimit, nuk i përgjigjet mbrojtjes së të drejtave të debitorit, i cili do të kalojë të gjitha procedurat e përfundimit të gjykimit me palë kundërshtare.

13. Në analizë të kriterit të legjitimitit “arsye serioze për antikushtetutshmëri”, Gjykata vëren se gjykata referuese nuk argumenton mjaftueshëm në nivel kushtetues shkeljen e të drejtave të debitorit për një fazë përmblylëse të procesit, që nga pikëpamja e themelit për të drejtat dhe detyrimet juridiko - civile të palëve kontraktuale është përfunduar, ndërkohë që, nga ana tjetër, afati prezumohet t'i shërbejë përshpejtimit të procesit gjyqësor në funksion të përfundimit të fazës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë në fushën kredive bankare dhe institucioneve jobankare.

14. Megjithatë, Gjykata konstaton se gjykatës referuese i ka paraqitur kërkesë debitori me objekt anulimin e veprimeve përmbartimore dhe marrjen e masës së pezullimit ndaj veprimeve përmbartimore të mëtejshme, konkretisht shitjen e sendit në ankand, veprim procedural të cilin gjykata referuese nuk kishte pengesë që ta ndërmernte me vendim të ndërmjetëm, referuar nenit 610 të KPC-së. Gjykata referuese e ka pasur të drejtën e marrjes së masës së pezullimit, si masë mbrojtëse, dhe nuk e ka ushtruar këtë kompetencë në interes të mbrojtjes së të drejtave të debitorit, i cili ia kishte kërkuar në objektin e padisë. Në këtë kuptim, edhe efektiviteti i kësaj mase mbrojtëse nuk është testuar nga gjykata referuese, e cila ka prezumuar mospërmblylljen e procesit gjyqësor të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore brenda 20 ditëve, sipas përcaktimeve ligjore të nenit 610 të KPC-së.

15. Në vlerësimin e Gjykatës, gjykata referuese nuk pengohet në marrjen e vendimit të pezullimit, pasi nga shqyrtimi i normës ligjore, objekt kundërshtimi për antikushtetutshmëri, nuk varet zgjidhja përfundimtare e çështjes në shqyrtim.

B. Për legjitimitimin e Avokatit të Popullit

16. Neni 134/1, shkronja “dh”, i Kushtetutës, e ka vendosur Avokatin e Popullit në rrethin e subjekteve që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues abstrakt të normës, por sipas pikës 2 të po këtij neni, kjo e drejtë kufizohet vetëm për çështjet që lidhen me interesat e këtij subjekti. Neni 60 i Kushtetutës përcakton se Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

17. Gjykata ka theksuar se interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur, si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor ose nga veprimet dhe mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve, apo kur shkelja e të drejtave, lirive dhe interesave të individit vjen si rezultat i vetë përmbajtjes së këtyre ligjeve apo akteve, d.m.th. kur ato janë në kundërshtim me Kushtetutën. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij. Në



këtë rast ai ka të drejtë t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të propozojnë ndryshime për përmirësimin e ligjeve ose të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve të tilla. Kompetenca e Avokatit të Popullit për t'iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë, që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike. Dhe është në diskrecionin e tij të zgjedhë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e individëve, nëse një normë është *prima facie* antikushtetuese (*shih vendimin nr. 20, datë 04.04.2014; nr. 29, datë 31.05.2010; nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po në funksion të legjitimitit *rationae materie*, Gjykata ka theksuar se interesi i Avokatit të Popullit për ta vënë atë në lëvizje, shqyrtohet rast pas rasti. Ky interes do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit (*shih vendimet nr. 40, datë 16.11.2007; nr. 10, datë 18.03.2013; nr. 14, datë 17.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se Avokati i Popullit pretendon se kufizimi i rënies së masës së pezullimit të veprimeve përmbarimore vetëm në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e aktit të dhënies së kredisë dhe jo për gjitha llojet e titujve ekzekutivë, shkel të drejtën e zhvillimit të procesit të ekzekutimit për të gjitha llojet e titujve ekzekutivë sipas të njëjtës procedurë. Po sipas tij, kufizimi i vendosur në nenin 610 të KPC-së, në lidhje me rënien e masës së pezullimit brenda 20 ditëve, do të justifikohet në rast se do t'i shërbente një interesi publik të gjerë dhe jo vetëm disa subjekteve kredidhënëse, siç parashikon dispozita ligjore në fjalë.

20. Gjykata çmon se Avokati i Popullit nuk ka parashtruar mjaftueshëm argumente për shkeljen e të drejtave të individit gjatë fazës së ekzekutimit të proceseve gjyqësore. Ky subjekt nuk argumenton se deri ku të drejtat dhe interesat e individit janë disproporcionalisht të pambrojtura në raport me të drejtat e subjekteve të tjera procedurale në fazën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë në fushën e kredive bankare nga dispozita objekt gjykimi. Po kështu, AP-ja nuk argumenton se pse në kuadrin e kufizimit të procesit të rregullt ligjor nuk i jepet

mbrojtje efektive individit nga dispozita objekt kundërshtimi, e cila ka parashikuar mjetin procedural të ankimit dhe të pezullimit ndaj veprimeve përmbarimore, pikërisht për mbrojtjen ndaj veprimeve të paligjshme të përmbaruesit gjyqësor.

21. Nga ana tjetër, duke e vlerësuar legjitimitimin e AP-së në vështrim të standardeve të mësipërme (supra §18), Gjykata çmon se ky subjekt nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, për arsye se nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis interesit institucional apo funksionit kushtetues që kryen dhe dispozitës ligjore, që kërkon të shpallet si e papajtueshme me Kushtetutën. Në vlerësimin e Gjykatës, AP-ja nuk ka arritur të provojë një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete.

22. Për sa më lart, gjykata referuese nuk plotëson kriteret e legjitimitit, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, ashtu si dhe Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134, pika 1, shkronjat “d” dhe “dh” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkesë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Avokatin e Popullit dhe me objekt: “Deklarimi i kushtetutshmërisë së fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile “Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimi e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet si e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga



momenti i dhënies së vendimit të pezullimit”, nuk pajtohem pjesërisht me argumentet e shumicës, lidhur me mungesën e legjitimitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ndaj e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel.

2. Në qëndrimin e saj për këtë çështje, shumica shprehet se gjykata referuese nuk pengohet në marrjen e vendimit të pezullimit, pasi nga shqyrtimi i normës ligjore, objekt kundërshtimi për antikushtetutshmëri, nuk varet zgjidhja përfundimtare e çështjes në shqyrtim (§15 i vendimit).

3. Siç është evidentuar edhe nga shumica, kërkesa në rrugë incidentale, nëpërmjet së cilës gjykatat e zakonshme kanë akses në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejta midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit. Në vendimin e saj gjykata ose gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që çmon se janë të papajtueshme me normat ose parimet e Kushtetutës (§10 i vendimit).

4. Po kështu gjatë jurisprudencës së saj, kur ka zhvilluar kriteret e legjitimitetit të gjykatës referuese në kontrole incidentale të normës ligjore, Gjykata ka theksuar se është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t’i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës së individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 7, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në çështjen konkrete, gjykata referuese ka

argumentuar në kërkesën e saj se pavarësisht përpjekjeve të saj për interpretim, neni 610 i KPC-së është e vetmja dispozitë që trajton padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore. Në përmbajtje të kësaj dispozite disiplinohet edhe procedura e pezullimit të ekzekutimit, në rastin kur është ngritur një padi për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore. Sipas kësaj gjykate, rastet e pezullimit të ekzekutimit renditen në mënyrë shteruese në nenin 615 të KPC-së. Megjithatë, kjo dispozitë në shkronjën “a” të saj referon te nenet 609, 610 dhe 612 të këtij Kodi, kur disponon se ekzekutimi pezullohet me vendim të Gjykatës. Nga ana tjetër, në këto dispozita pezullimi i ekzekutimit ka gjetur rregullime të ndryshme, për sa i përket afatit të zbatimit të kësaj mase, kur titulli rrjedh nga një akt dhënie kredie nga një bankë apo institucion bankar. Për këtë arsye, sipas gjykatës referuese, nuk ka dispozitë tjetër për t’u zbatuar si alternativë për nenin 610 të KPC-së.

6. Neni 610 i KPC-së në tërësinë e tij është dispozitë procedurale, i cili ka për objekt rregullimin e çështjes që lidhet me masat paraprake garantuese, sikundër është pezullimi i ekzekutimit. Kjo dispozitë ankimin kundër veprimeve përmbartimore e vë në dispozicion të të gjitha palëve të përfshira në proces, pasi parashikon se kundër veprimeve të përmbartuesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit apo refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur edhe në raste të tjera nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënie kredie bankare ose akt për dhënie kredie nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit.

7. Në vlerësimin tim, përderisa gjykata referuese ka pasur për zgjidhje një padi me objekt anulimin e vendimeve përmbartimore, “vendim për shpallje ankand”, si dhe pezullimin e veprimeve përmbartimore të mëtejshme, konkretisht shitjen e sendit në ankand, atëherë neni 610 i KPC-së, specifikisht shtesa në këtë dispozitë në lidhje me rënie e masës së pezullimit, kur titull ekzekutiv



është akt kredie, ishte dispozita e cila do të zbatohet në rastin konkret. Në kushtet kur gjykatës i ishte kërkuar marrja e vendimit të pezullimit të veprimeve përmbarimore, në eventualitetin që ky vendim do të binte nga fuqia 20 ditë pas dhënies së tij, kriterin procedural të lidhjes së drejtpërdrejtë, që është ajo mes normës së pretenduar si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, kjo kërkesë e plotëson. Njëkohësisht edhe argumentet se mosndjekja e rrugës së kontrollit incidental do të sillte zbatimin e një procedure me pasoja antikushtetuese për të drejtat e individit/debitor, janë të mjaftueshme *prima facie* që kërkesa të gjykohej për themelin e pretendimeve.

8. Si përfundim, gjykata referuese ka argumentuar mjaftueshëm dhe ka parashtuar pretendime serioze se ndodhej para një situatë ku zgjidhja e çështjes varej nga norma, e cila bie ndesh me disa parime dhe standarde kushtetuese. Për rrjedhojë, kërkesa nuk duhej rrëzuar për mungesë legjitimitimi të gjykatës referuese, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, dhe shumica duhej ta kishte shqyrtuar papajtueshmërinë me Kushtetutën të fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610 të KPC-së. Për më tepër, bashkohem me shumicën në lidhje me dispozitivin e vendimit, pra rrëzimin e kërkesës, pasi mendoj se nga shqyrtimi në tërësi i çështjes, kjo kërkesë duhej rrëzuar për shkak të pathemeltësisë së pretendimeve të gjykatës referuese, të cilat nuk qëndrojnë nga pikëpamja kushtetuese.

Kryetar: Bashkim Dedja

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (gjykata referuese) dhe Avokatit të Popullit lidhur me antikushtetueshmërinë e fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja) “*Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit*”, me arsyetimin se gjykata referuese nuk plotëson kriteret e legjitimitimit, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, ashtu si dhe Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës (*shih paragrafin nr. 22 të vendimit*).

2. Edhe pse pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, ndaj mendim të ndryshëm në lidhje me legjitimitimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Në këto kushte çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel.

3. Sikurse konstaton edhe shumica, gjykatës referuese i është paraqitur kërkesë nga debitori me objekt anulimin e veprimeve përmbarimore dhe marrjen e masës së pezullimit ndaj veprimeve përmbarimore të mëtejshme, konkretisht shitjen e sendit në ankand (*shih paragrafët 1 dhe 14 të vendimit*). Kërkesa e debitorit bazohet në nenin 610 të KPC-së. Gjatë shqyrtimit të çështjes, gjykata referuese ka ngritur pretendime në lidhje me dispozitën objekt gjykimi, që parashikon pezullimin e ekzekutimit si një masë paraprake dhe që synon të ndalojë procedurat e ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim garantimin e të drejtave të debitorit. Sipas gjykatës referuese, afati 20-ditor, si afat i masës së pezullimit të ekzekutimit, nuk i përgjigjet mbrojtjes së të drejtave të debitorit (*shih paragrafin nr. 12 të vendimit*).

4. Shumica ka arsyetuar se lidhur me kriterin “arsye serioze për antikushtetueshmëri”, gjykata referuese nuk argumenton mjaftueshëm në nivel kushtetues shkeljen e të drejtave të debitorit për një fazë përmbyllëse të procesit ... (*shih paragrafin nr. 13 të vendimit*), se Gjykata referuese e ka pasur të drejtën e marrjes së masës së pezullimit, si masë mbrojtëse dhe nuk e ka ushtruar këtë kompetencë në interes të mbrojtjes së të drejtave të debitorit, i cili ia kishte kërkuar në objektin e padisë. Në këtë kuptim, edhe efektiviteti i kësaj mase mbrojtëse nuk është testuar nga gjykata referuese, e cila ka prezumuar mospërmbylljen e procesit gjyqësor të kundërshtimit të veprimeve përmbarimore brenda 20 ditëve, sipas përcaktimeve ligjore të nenit 610 të KPC-së (*shih paragrafin nr. 14 të vendimit*). Për pasojë, shumica ka arritur në përfundimin se gjykata referuese nuk pengohet në marrjen e vendimit të pezullimit, pasi nga shqyrtimi i normës ligjore, objekt kundërshtimi për antikushtetueshmëri, nuk varet zgjidhja përfundimtare e çështjes në shqyrtim (*shih paragrafin nr. 15 të vendimit*).

5. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se legjitimitimi i gjykatës referuese gjatë kontrollit incidental të normës ligjore, për papajtueshmëri me Kushtetutën, kërkon plotësimin e disa kushteve, të cilat janë evidentuar edhe në vendimin e shumicës (*shih paragrafin nr. 11 të vendimit*). Gjithashtu, Gjykata,



në vazhdimësi, sa herë ka çmuar se konstatimet e papajtueshmërisë me Kushtetutën të dispozitave ligjore të pretenduara nga ana e gjykatës referuese ngrënë *prima facie* probleme kushtetutshmërie të tyre (dispozitave), i ka legjitimuar në paraqitjen e kërkesës për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve para kësaj Gjykate (shih vendimin nr. 47 datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

6. Nga kjo pikëpamje vlerësoj se vendimi i shumicës është një zgjidhje teknike dhe formale dhe se, përkundrazi, gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate për arsyet e mëposhtme.

7. Nisur nga objekti i çështjes për shqyrtim përpara gjykatës referuese, sikurse u përmend me lart (shih paragrafin nr. 3 të këtij mendimi), neni 610 i KPC-së është dispozita e vetme që duhet të zbatohet prej saj për zgjidhjen e çështjes. Pra plotësohet kriteri i identifikimit të dispozitës nga ana e gjykatës referuese, si dhe kriteri që nuk ekzistojnë dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen (këto kritere nuk vihen në dyshim as nga shumica).

8. Nga sa më lart, përderisa objekti i shqyrtimit të çështjes përpara gjykatës referuese ka të bëjë me pezullimin e veprimeve përbarimore dhe nuk lidhet me themelin e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, mendoj se gjykimi përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk mund të përfundonte në mënyrë të pavarur nga kontrolli i kushtetutshmërisë së dispozitës së kundërshtuar.

9. Gjithashtu, për mendimin tim, në thelb, pretendimet e gjykatës referuese kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Në aspektin kushtetues çfarë gjykata referuese shtron për diskutim, ka të bëjë me faktin nëse kufizimet (masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit, kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit), që i janë vendosur të drejtës për një proces të rregullt ligjor, kanë respektuar kriteret e përcaktuara nga neni 17 i Kushtetutës. Për pasojë, sipas këndvështrimit tim, në ndryshim nga sa arsyeton shumica, plotësohet edhe kriteri i legjitimitetit “arsye serioze për antikushtetutshmëri” i dispozitës së kundërshtuar.

10. Lidhur me nenin 17 të Kushtetutës, pa pasur si qëllim analizën e themelit të çështjes në shqyrtim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë duhen bërë sipas disa kritereve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës. Kjo dispozitë, përveç parashikimit të kufizimit me ligj dhe arsyes publike që përligj kufizimin, përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë, i njohur ndryshe si parimi i proporcionalitetit. Ky i fundit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (shih vendimet nr. 10, datë 19.03.2008; nr. 12, datë 28.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Pikërisht në këtë drejtim Gjykata duhet të vlerësonte pretendimet e ngritura nga gjykata referuese.

11. Si përfundim, duke ritheksuar rëndësinë e kontrollit incidental të normës, pasi vendimet e kësaj Gjykate kanë efekte *erga omnes*, vlerësoj se në rastin konkret Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier duhej të legjitimohej për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Gjithsesi, pavarësisht përpjekjeve të gjykatës referuese, mendoj se pretendimet e saj janë të pabazuara, pasi kufizimi i vendosur nëpërmjet fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610 të KPC-së përmbush kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Në këtë drejtim mendoj se kërkesa e saj duhej rrëzuar.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 31, datë 25.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“



me sekretare Edmira Babaj, në datën 11.02.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 48/16 Akti që i përket:

KËRKUES: Vangjel Kondili, përfaqësuar me prokurorë të posaçme nga avokat Ravik Gurra.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 45, datë 20.07.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nr. 63, datë 09.11.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, si dhe nr. 00-2012-677(130), datë 09.05.2012 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15/2, 23, 29/1, 31, 32, 33, 35 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të mbrojtësit të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 45, datë 20.07.2009, ka vendosur deklarinim fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2/a i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim. Në këtë proces gjyqësor kërkuari është gjykuar në mungesë.

2. Kundër vendimit të mësipërm kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda si Prokuroria e Krimeve të Rënda, ashtu edhe të pandehurit e tjerë që kanë qenë të pranishëm gjatë procesit gjyqësor. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 63, datë 09.11.2009, në lidhje me kërkuarin, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të deklarinimit fajtor dhe të dënimit me 10 vjet burgim. Në këtë proces kërkuari ka qenë i përfaqësuar me mbrojtës të caktuar kryesisht.

3. Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur rekurs Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe kundërrekurs dy nga të pandehurit e tjerë. Gjykata

e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-677, datë 09.05.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

4. Kërkuari është ekstraduar në Shqipëri nga Spanja dhe në datën 05.03.2014 është njohur me urdhrin e prokurorisë për ekzekutimin e vendimit të dënimit në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, fakt i cili rezultoi nga procesverbali i mbajtur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, bashkëngjitur kërkesës.

II

5. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 23.05.2014, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve gjyqësore penale të zhvilluara në mungesë. Në mënyrë të përmbledhur ai parashtron si vijon:

5.1 Është cenuar *e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi procesi i deklarinimit fajtor dhe dënimit është zhvilluar në mungesë. Ai ka qenë në emigrim dhe nuk është njoftuar nga autoritetet shtetërore për vendimin gjyqësor penal.

5.2 Është cenuar *e drejta e ankimit*, pasi duke mospasur dijeni për procesin gjyqësor, nuk ka mundur të kundërshtojë vendimet gjyqësore, të cilat nuk janë kundërshtuar as nga mbrojtësi i caktuar kryesisht.

6. **Subjekti i interesuar Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim se kërkuari nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të procesit kushtetues, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave që pretendon se i janë cenuar. Kërkuari pas ekstradimit duhet të paraqiste kërkesë për rivendosje në afat, pasi interpretimi e zbatimi i legjislacionit procedural penal dhe shqyrtimi i ekzistencës ose jo të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimit mbetet atribut i Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit

7. Gjykata paraprakisht vlerëson të analizojë prapësimin e subjektit të interesuar mbi moslegjitimitimin e kërkuarit me argumentin se nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Sipas Prokurorisë së Përgjithshme kërkuari, si i gjykuar në mungesë, mund të paraqesë kërkesë përpara juridiksionit kushtetuese vetëm pasi të ketë



përfunduar procesi gjyqësor i rivendosjes në afat të ankimit.

8. Bazuar në qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese në lidhje me kuptimin e neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, individi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme (*shih vendimet nr. 36 datë 10.11.2010; nr. 3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individi, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'i jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 04.03.2010; nr. 15, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata konstaton se çështja e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion nga i gjykuari në mungesë është trajtuar gjerësisht nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ-ja), e cila mban qëndrimin se Konventa u lë shteteve kontraktuese diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjetit të parashikuar për të garantuar se sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me dispozitat e nenit 6. Në veçanti, mjetet procedurale, të ofruara nga e drejta dhe praktika e brendshme, duhet të tregojnë se janë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur e për t'u mbrojtur vetë dhe as nuk ka kërkuar t'i shmanget gjykimit (*shih Sejdivic kundër Italisë, [DHM], nr. 56581/00, § 83, 1 mars 2006*).

10. Ndonëse GJEDNJ-ja nuk përcakton shprehimisht mjetin procedural efektiv për rivendosjen e të drejtave të pretenduara si të cenuara, në jurisprudencën e saj mbizotëron qëndrimi se detyrimi i ankuesve është pikërisht shterimi i mjeteve të brendshme ligjore, të cilat janë të vlefshme në teori dhe praktikë, në periudhën

përkatëse, të aksesueshme, që mund të sigurojnë ndreqjen e ankimeve të tyre dhe që ofrojnë perspektiva të arsyeshme suksesi (*shih Sejdivic kundër Italisë, § 46*). Për më tepër, vlerësimi nëse janë shteruar mjetet e brendshme ligjore, normalisht bëhet duke iu referuar datës në të cilën është depozituar ankimi në gjykatë, megjithëse ky rregull përbën një përjashtim, i cili mund të justifikohet nga rrethanat specifike sipas rastit (*shih Baumann kundër Francës, nr. 33592/96, § 47, GJEDNJ 2001-V; Babylonová kundër Sllovakisë, nr. 69146/01, § 44, GJEDNJ 2006-VIII; Içet Haxhia kundër Shqipërisë, nr. 34783/06, § 47, i datës 05.11.2013*).

11. Po ashtu, në disa vendimmarrje kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja, duke analizuar veçanërisht praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë mbi të drejtën e ankimit të të gjykuarve në mungesë (vendimi unifikues penal nr. 1/2011), ka theksuar se efektiviteti i kërkesave për rivendosje në afat të ankimit nga të gjykuar në mungesë, duhet të konsiderohet i hapur ndaj dyshimeve nisur nga vendimet e gjykatave kombëtare në çështje të tjera, ku kërkesa e të akuzuarit për rivendosje në afat është rrëzuar, *inter alia*, me arsyetimin se i akuzuari, gjatë seancave gjyqësore *in absentia*, mbrohej nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët. Për rrjedhojë, GJEDNJ-ja nuk është e bindur se një kërkesë për rivendosje në afat, kur aplikanti është përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët, do të kishte perspektiva reale suksesi. Prandaj ankimi para Gjykatës Kushtetuese është një mjet ligjor efektiv për të kundërshtuar një dënim në mungesë (*shih Shkalla k. Shqipërisë, §§ 59-62*). Për këtë arsye, GJEDNJ-ja ka theksuar se në rast se gjenden disa mjete ligjore, të cilave mund t'u referohet aplikanti, ai është i lirë të zgjedhë mjetin që trajton ankimin e tij/e saj (*shih Croke kundër Irlandës, nr. 33267/96, 15 qershor 1999*). Me fjalë të tjera, kur mjeti ligjor është zgjedhur, nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër, që në esencë ka të njëjtin qëllim (*shih Moreira Barbosa kundër Portugalisë, nr. 65681/01, 2004-V*).

12. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kërkuesi është ekstraduar nga Spanja dhe është njohur me urdhrin e prokurorisë për ekzekutimin e vendimit të dënimit në datën 05.03.2014, në ambientet e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, fakt i cili rezulton nga procesverbali i mbajtur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore.

13. Pas ekstradimit, kërkuesi ka depozituar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila mban



datën 23.04.2014. Gjithashtu, ai i është drejtuar edhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda përmes një kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, e cila nuk është pranuar. Kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, e cila ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm. Po ashtu, kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili është ende në proces shqyrtimi.

14. Në vështrim të standardeve të mësipërme dhe rrethanave konkrete të çështjes, Gjykata çmon se kërkuesi i gjykuar në mungesë në të gjitha shkallët, pas ekstradimit nuk kishte detyrimin për shterimin e mjeteve juridike në dispozicion përpara paraqitjes së ankimit individual kushtetues. Bazuar në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë mbi të drejtën e ankimit të të gjykuarve në mungesë (kur janë të bashkëpandehur) ekzistojnë dyshime në lidhje me pranueshmërinë e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, duke qenë se Kolegji Penal i ka shqyrtuar në tërësi meritat e çështjes në fjalë bazuar në rekursin e paraqitur nga njëri prej të bashkëpandehurve dhe ka lënë në fuqi vendimin e dënimit.

15. Në këtë kontekst, Gjykata, bazuar në jurisprudencën kushtetuese dhe atë të GJEDNJ-së mbi mjetin efektiv për rivendosjen e të drejtave të pretenduara si të cenuara nga të gjykuarit në mungesë, vlerëson se paraqitja nga ana e kërkuesit edhe e kërkesës për rivendosje në afat nuk përbën pengesë për shqyrtimin e ankimit individual kushtetues, për faktin se është pikërisht ky mjeti efektiv që ofron mundësitë e arsyeshme për rivendosjen e të drejtave të pretenduara, duke kundërshtuar dënimin *in absentia*.

16. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi pretendimet e tij përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet janë prima facie në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata, bazuar në aktet e administruara në dosjen e çështjes, vëren se kërkuesi është njohur me vendimin penal nr. 45, datë 20.07.2009 përmes njoftimit të datës 05.03.2014, datë në të cilën ai është arrestuar në zbatim të urdhrin të datës 17.12.2009 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Rrjedhimisht, duke qenë se data e fillimit të afatit dy-vjeçar, brenda të cilit kërkuesi ka detyrimin të depozitë

një ankim kushtetues, është 05.03.2014 dhe se kërkesa në Gjykatën Kushtetuese mban datën 23.05.2014, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

17. Në përfundim, Gjykata vlerëson se prapësimi i subjektit të interesuar Prokuroria e Përgjithshme, në lidhje me mungesën e legjitimitimit të kërkuesit të gjykuar në mungesë, është i papabazuar.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar

18. Kërkuesi, në thelb, ka pretenduar se nuk ka marrë efektivisht dënimin për procesin gjyqësor në ngarkim të tij, si rezultat i mospërmbljes nga ana e autoriteteve të detyrimeve që burojnë nga KPP-ja për njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet. Për rrjedhojë, atij i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar.

19. Gjykata në jurisprudencën e saj, në referim edhe të vendimmarrjes së GJEDNJ-së, ka rikonfirmuar vazhdimisht qëndrimin se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë, që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Qëllimi i garancive të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 6 të Konventës duhet të vlerësohet në veçanti në dritën e së drejtës më të përgjithshme për një gjykim të drejtë garantuar nga paragrafi 1 i saj. Në çështjet penale sigurimi i informacioneve të plota dhe të detajuara lidhur me akuzat kundër të pandehurit përbën një kusht paraprak thelbësor për të garantuar se procedimet janë të drejta. Megjithatë jo absolute, e drejta e çdo personi të akuzuar për një vepër penale për t'u mbrojtur efektivisht nga një avokat, nëse është e nevojshme, të caktuar zyrtarisht, përbën një nga karakteristikat themelore të një gjykimi të drejtë. Personi i akuzuar për një vepër penale nuk humbet përfitimin e kësaj të drejte thjesht për shkak të mospranisë së tij në gjyq. Është me rëndësi vendimtare për drejtësinë e sistemit të drejtësisë penale që i pandehuri të mbrohet si duhet si në shkallë të parë, ashtu edhe në apel (*shih Izet Haxhia kundër Shqipërisë*, § 61).

20. Neni 6 i KEDNJ-së nuk e ndalon një person të heqë dorë nga të drejtat e tij. Megjithatë, për qëllimet e Konventës do të konsiderohet efektive që të drejtat e atij që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoqe dhe të



shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat. E drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Është e një rëndësie thelbësore që i akuzuari të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose të dëshmitarëve (*shih vendimet nr. 26, datë 08.05.2012; nr. 5, datë 25.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Lidhur me zbatimin e rregullave procedurale të njoftimit në procesin e dënimit të të gjykuarit në mungesë, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se marrja dijani jo në mënyrë të plotë dhe në rrugë informale, nuk mund të jetë e mjaftueshme. Fakte të ndodhura ose të njohura mund të përbëjnë tregues të padiskutueshëm për gjykatën se i akuzuari ka dijani për ekzistencën e procedimeve penale kundër tij dhe për natyrën e shkakun e akuzës, siç janë rastet kur i akuzuari deklaroi publikisht ose me shkrim se ai nuk do t'i përgjigjet thirrjeve për gjyq për të cilat ai ka marrë dijani përmes burimeve të ndryshme dhe jo nga autoritetet, ose vijon t'i shmanget përpjekjes për arrestimin e tij, apo kur autoritetet u paraqiten materiale të cilat tregojnë qartë se ai është në dijani të procedurave në pritje ndaj tij dhe të akuzave me të cilat përballet. Ndërkohë, thjesht mungesa e ankuesit në shtëpi nuk mjafton për të konsideruar se ai kishte dijani për procedurat dhe, për rrjedhojë, largohet (*shih vendimin nr. 5, datë 25.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Sipas GJEDNJ-së, kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk është vënë në dijani personalisht, nuk mund të arrihet thjesht në

përfundimin se ai ka hequr dorë nga e drejta që të paraqitet në gjyq dhe të mbrohet vetë, nisur nga statusi i tij “në mungesë”, që u krijua nga prezumimi me bazë të pamjaftueshme faktike. Para se të thuhet se i pandehuri në mënyrë të nënkuptuar, nëpërmjet sjelljes së tij, ka hequr dorë nga një e drejtë e rëndësishme, sipas nenit 6 të Konventës, duhet të tregohet se në mënyrë të arsyeshme ai mund të kishte parashikuar se cilat do ishin pasojat e sjelljes së tij (*shih Sejdivic kundër Italisë, §87*).

23. Nga sa më sipër, Gjykata rithekson se është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigorozë, konform kërkesave procedurale, të pandehurin, ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se ai ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve është detyrë e organeve kompetente. Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigorozë të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe kompetenca e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat për njoftimin (*shih vendimin nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata, nisur nga qëndrimi i konsoliduar i jurisprudencës kushtetuese se rregullat e ndjekura për njoftimin e të gjykuarit në mungesë dhe efektiviteti i njoftimit të tij nga ana e autoriteteve analizohen në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes, në rastin konkret, çmon të vlerësojë nëse autoritetet kompetente kanë përmbushur efektivisht detyrimin për njoftimin e kërkuesit përmes zbatimit rigoroz të kërkesave procedurale për njoftimin e tij.

25. Nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se urdhri i Prokurorisë për Krime të Rënda për ndalimin e menjëhershëm të të kërkuarit mban datën 22.05.2005. Masa e sigurisë “arrest me burg” është caktuar me vendimin nr. 264, datë 17.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Ndërkohë, akuza kundër kërkuesit i është njoftuar mbrojtësit



të caktuar kryesisht me vendimin e datës 05.01.2007.

26. Nga procesverbali i mbajtur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore i Komisarariatit të Policisë Elbasan në datën 24.01.2007, pas kontrollit të ushtruar në banesën e kërkuesit në fshatin Bradadesh, Elbasan, rezulton se ai nuk gjendej aty dhe sipas deklarimeve të familjarëve (nëna dhe babai) ai ndodhej në Belgjikë prej rreth dy vjetësh. Ky fakt konfirmohet edhe nga procesverbali mbi kërkimin e personit që nuk gjendet dhe procesverbali i deklarimit nga persona që tregojnë rrethanat e dobishme për qëllime të hetimit të datës 24.01.2007, ku pasqyrohen deklaratimet e babait të kërkuesit sipas të cilave *“djali është larguar në vitin 1998 ... dhe ka mbërritur në Belgjikë, ku ka kërkuar strehim politik e më pas ka marrë edhe nënshetësi belge. Ai ka ardhur në Shqipëri vetëm dy herë, në vitin 2003 dhe vitin 2004. Aktualisht është në Bruksel, por adresën e saktë të djalit nuk e di...”*.

27. Në datën 25.01.2007 Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda ka paraqitur kërkesë pranë gjykatës për deklarimin e ikjes së kërkuesit, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 12, datë 26.01.2007 të asaj gjykate, që ka caktuar edhe mbrojtësin kryesisht, me qëllim mbrojtjen e interesave të kërkuesit gjatë veprimeve të mëtejshme hetimore. Në lidhje me aktet që pasqyrojnë përfundimin e hetimeve, konstatohet se procesverbali mbi njohjen e materialeve të dosjes është nënshkruar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht pa asnjë vërejtje.

28. Gjykata konstaton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e ka njoftuar kërkuesin për zhvillimin e procesit gjyqësor përmes disa fletëthirrjeve, të cilat janë nënshkruar nga i ati dhe shoqërohen nga raportshërbimet e OPGJ-së. Po ashtu, Gjykata vëren se për zhvillimin e seancave gjyqësore ka marrë dijeni edhe mbrojtësi i caktuar kryesisht, i cili i ka nënshkruar rregullisht fletëthirrjen drejtuar atij. Ndërkohë shkresat nr. 563/1prot., datë 13.03.2007, nr. 698/1prot., datë 19.03.2007, nr. 897/1prot., datë 05.04.2007 të Komisarariatit të Policisë Elbasan drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda konfirmojnë faktin se i pandehuri ndodhet familjarisht në Belgjikë.

29. Duke iu referuar dosjes gjyqësore Gjykata vëren se në të nuk gjendet i administruar ndonjë akt për njoftimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës

së Parë për Krime të Rënda kërkuesit, sipas kërkesave të nenit 386 të KPP-së. Ndërkohë konstatohet se ankimet e paraqitura kundër vendimit të mësipërm nga mbrojtësit e të pandehurve të pranishëm në proces dhe prokuroria i janë komunikuar vetëm mbrojtësit të kërkuesit të caktuar kryesisht, fakt që provohet nga dëftesat e komunikimit të datave 23.07.2009, 27.07.2009, 28.07.2007 dhe 14.08.2009, të nënshkruara prej tij.

30. Për sa i përket njoftimit të kërkuesit për zhvillimin e seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Gjykata vëren se fletëthirrja drejtuar kërkuesit është nënshkruar nga babai i tij, kurse kopja që i është dërguar mbrojtësit të caktuar kryesisht është nënshkruar rregullisht personalisht prej tij. Në seancën gjyqësore të datës 29.10.2009 kërkuesit në mungesë i është caktuar kryesisht një përfaqësues ligjor tjetër, i cili ka përgatitur edhe diskutimin përfundimtar.

31. Gjykata vëren se procesi gjyqësor penal ka vijuar edhe në Gjykatën e Lartë, pas rekursit të paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda. Kopja e tij i është komunikuar vetëm mbrojtësit të caktuar kryesisht, fakt i cili provohet nga dëftesa e komunikimit e datës 04.12.2009. Në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë kërkuesit i është caktuar mbrojtës kryesisht, i cili ka pretenduar veçimin e çështjes, me argumentin se nëse do të lihej në fuqi vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, të pandehurit do t'i rëndohej pozita procedurale dhe nuk do të kishte mundësi ankimi kundër vendimit.

32. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vëren se interesat ligjore të kërkuesit të gjykuar në mungesë, si gjatë fazës së hetimeve paraprake, ashtu dhe gjatë proceseve gjyqësore penale në ngarkim të tij, janë përfaqësuar nga mbrojtës të caktuar kryesisht. Në vlerësimin e Gjykatës mbrojtësit ligjorë kanë ushtruar tagra që lidhen me përfaqësimin e kërkuesit në mungesë dhe jo të drejta procedurale që i rezervohen personalisht atij, siç është e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda apo e rekursit në Gjykatën e Lartë.

33. Përveç sa më sipër, Gjykata vlerëson se moskomunikimi i ankimit ose rekursit kërkuesit, por vetëm mbrojtësit të caktuar kryesisht, mungesa e një prokure të posaçme që të shprehë vullnetin e tij për caktimin e mbrojtësve ligjorë ose për delegimin e këtij vullneti familjarëve dhe përcaktimin shprehimisht të kufijve e tagrave të



përfaqësimit në procesin penal, mosrespektimi i procedurave për njoftimin e fletëthirrjeve dhe pasja e të metave formale në përmbajtjen e tyre, përbëjnë fakte bindëse se kërkuesi, në mungesë të njoftimit efektiv dhe zyrtar nga autoritetet, nuk ka pasur asnjë mundësi tjetër për të marrë dijeni për procesin gjyqësor, deklarinim fajtor dhe dënimin e tij.

34. Gjykata rithekson se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi si i tërë ka qenë i rregullt, duke u ndaluar në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në vendimet e veta Gjykata ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

35. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme kanë pasur disa indicie mbi shtetin ku kërkuesi jetonte me familjen e tij dhe statusin e posaçëm të azilantit politik në Belgjikë. Megjithatë, në dosje nuk gjendet i administruar ndonjë urdhër kërkimi ndërkombëtar, me qëllim njoftimin e tij, në referim të përcaktimeve të nenit 142 të KPP-së, që parashikon se kur ka të dhëna të pamjaftueshme për të proceduar me dërgimin e letërrekomandesë me lajmërim marrjeje, si mënyrë për njoftimin e akuzës, autoriteti procedues, përpara se të nxjerrë vendimin e mosgjetyes, urdhëron të bëhen kërkime edhe jashtë territorit të shtetit, sipas rregullave të caktuara në marrëveshjet ndërkombëtare.

36. Gjykata, bazuar në nenin 425, që përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes edhe në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, vlerëson se kjo e fundit, gjatë procesit gjyqësor të gjykimit të ankimit të paraqitur nga prokurori dhe të pandehurit e tjerë, para së gjithash kishte detyrimin ligjor të hetonte nëse vërtet kërkuesi, i gjykuar në mungesë dhe i mbrojtur nga mbrojtës kryesisht, gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk ka pasur dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij ose nëse ekzistonte ndonjë fakt ose rrethanë që të provonte se ai kishte hequr dorë vullnetarisht dhe në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë, duke iu shmangur me paramendim drejtësisë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit për Krime të

Rënda mund të vazhdonte me gjykimin në mungesë të kërkuesit vetëm pasi të ishte e sigurt se kërkuesi kishte marrë njoftim në formën që parashikon ligji.

37. Në këto kushte, për sa kohë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk ka marrë masa për përmbushjen efektive të standardeve të procesit të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të së drejtës së njoftimit efektiv si kusht thelbësor për ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes dhe për t'u dëgjuar e për të paraqitur ankim, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda duhet të shfuqizohet si jokushtetues.

38. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se në kushtet kur janë konstatuar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe për sa kohë ato nuk janë plotësuar ose korrigjuar edhe nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit, arrihet në përfundimin se edhe ky kolegji ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues. Për pasojë, Gjykata vlerëson se edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet si jokushtetues.

39. Në përfundim, Gjykata, bazuar në standardet kushtetuese dhe kërkesat procedurale penale lidhur me njoftimin e të pandehurit, kur ai nuk gjendet, si dhe të rrethanave konkrete të çështjes, vlerëson se organet shtetërore nuk kanë marrë të gjitha masat dhe nuk kanë kryer të gjitha veprimet e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore për njoftimin e kërkuesit Vangjel Kondili. Mosrespektimi i rregullave procedurale për njoftimin tij tregon mungesën e njoftimit efektiv dhe zyrtar për gjykimin e zhvilluar nga gjykatat e krimeve të rënda dhe Gjykata e Lartë dhe nuk provon se ai ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim.

40. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur ankim si rezultat i mosnjoftimit efektiv të tij nga autoritetet përgjegjëse, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "P", dhe 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë



10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2012-677, datë 09.05.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 63, datë 09.11.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, vetëm për pjesën në ngarkim të kërkuesit Vangjel Kondili.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Vitore Tusha

Anëtar kundër: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Gjykata ka pranuar pjesërisht kërkesën e shtetasit Vangjel Kondili dhe ka vendosur shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2012-677, datë 09.05.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nr. 63, datë 09.11.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, vetëm për pjesën në ngarkim të kërkuesit. Shumica ka arsyetuar se moskomunikimi i ankimit ose rekursit kërkuesit, por vetëm mbrojtësit të caktuar kryesisht, mungesa e një prokure të posaçme që të shprehë vullnetin e tij për caktimin e mbrojtësve ligjorë ose për delegimin e këtij vullneti familjarëve dhe përcaktimin shprehimisht të kufijve e tagrave të përfaqësimit në procesin penal, mosrespektimi i procedurave për njoftimin e fletëthirrjeve dhe mungesa e të metave formale në përmbajtjen e tyre, përbëjnë fakte bindëse se kërkuesi, në mungesë të njoftimit efektiv dhe zyrtar nga autoritetet, nuk ka pasur asnjë mundësi tjetër për të marrë dijeni për procesin gjyqësor, deklarimin fajtor dhe dënimin e tij (*shih paragrafin 33 të vendimit*).

2. Shumica, gjithashtu, ka vlerësuar se organet shtetërore nuk kanë marrë të gjitha masat dhe nuk kanë kryer të gjitha veprimet e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore për njoftimin e kërkuesit. Mosrespektimi i rregullave procedurale për njoftimin tij tregon mungesën e njoftimit efektiv dhe zyrtar për gjykimin e zhvilluar nga

gjykatat e krimeve të rënda dhe Gjykata e Lartë dhe nuk provon se ai ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Për rrjedhojë, ajo ka arritur në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për të paraqitur ankim si rezultat i mosnjoftimit efektiv të tij nga autoritetet përgjegjëse, janë të bazuara (*shih paragrafin 39-40 të vendimit*).

3. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret, kërkuesi nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës dhe, për rrjedhojë, kërkesa e tij duhej rrëzuar.

4. Sikurse konstaton edhe shumica, në thelb të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor qëndron fakti se ai nuk është njoftuar efektivisht për procesin penal të zhvilluar në ngarkim të tij. Kërkuesi pretendon se është vënë në dijeni për vendimin penal në datën 05.03.2014, datë kur është ekstraduar në Shqipëri.

5. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, është aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. E drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin t'i japë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Është e një rëndësie thelbësore që i akuzuari të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt të akuzuar për një vepër penale për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimin nr. 26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).



6. Sipas praktikës së kësaj Gjykate, si dhe të GJEDNJ-së është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (*shih vendimet nr. 30, datë 17.06.2010 dhe nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjithsesi, garancitë e përcaktuara nga neni 6 i KEDNJ-së nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë shprehimisht ose taktikisht. Po në këtë drejtim neni 33/2 i Kushtetutës parashikon se nuk mund të përfitojë nga e drejta për t'u dëgjuar personi që i fshihet drejtësisë. Por për qëllimet e KEDNJ-së do të konsiderohet efektive që të drejtat e atij që ka hequr dorë prej tyre të sanksionohen pa ekuivoqe dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i KEDNJ-së (*shih vendimin 26, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim, nga materialet e dosjes gjyqësore, rezulton se në fazën e hetimeve, pas urdhrorit të Prokurorisë për Krime të Rënda për ndalimin e menjëhershëm të të kërkuarit të datës 22.05.2005 dhe vendimit nr. 264, datë 17.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për masën e sigurisë “arrest me burg”, janë mbajtur disa procesverbale nga OPGJ-të e Komisarariatit të Policisë Elbasan. Në datën 24.01.2007, pas kontrollit të ushtruar në banesën e kërkuarit në fshatin Bradadesh, Elbasan, rezulton se ai nuk gjendej aty dhe sipas deklarimeve të familjarëve (nëna dhe babai) ndodhej në Belgjikë prej rreth dy vjetësh. Ky fakt konfirmohet edhe nga procesverbali për kërkimin e personit që nuk gjendet dhe procesverbali i deklarimit nga persona

që tregojnë rrethanat e dobishme për qëllime të hetimit të datës 24.01.2007, ku pasqyrohen deklaratimet e babait të kërkuarit, sipas të cilave “*djali është larguar në vitin 1998 ... dhe ka mbërritur në Belgjikë, ku ka kërkuar strehim politik e më pas ka marrë edhe nënshtetësi belge. Ai ka ardhur në Shqipëri vetëm dy herë, në vitin 2003 dhe vitin 2004. Aktualisht është në Bruksel, por adresën e saktë të djalit nuk e di...*”.

9. Në datën 25.01.2007 Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda ka paraqitur kërkesë pranë gjykatës për deklarimin e ikjes së kërkuarit, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 12, datë 26.01.2007 të kësaj gjykate, që ka caktuar edhe mbrojtësin kryesisht, me qëllim mbrojtjen e interesave të kërkuarit gjatë veprimeve të mëtejshme hetimore.

10. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e ka njoftuar kërkuarin për zhvillimin e procesit gjyqësor përmes disa fletëthirrjeve, të cilat janë nënshkruar nga i ati dhe shoqërohen nga raportshërbimet e OPGJ-së. Po ashtu, për zhvillimin e seancave gjyqësore ka marrë djeni edhe mbrojtësi i caktuar kryesisht, i cili i ka nënshkruar rregullisht fletëthirrjen drejtuar atij. Ndërkohë, shkresat nr. 563/1prot., datë 13.03.2007, nr. 698/1prot., datë 19.03.2007, nr. 897/1prot., datë 05.04.2007 të Komisarariatit të Policisë Elbasan drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda konfirmojnë faktin se i pandehuri ndodhet familjarisht në Belgjikë.

11. Edhe për zhvillimin e seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, konstatohet se fletëthirrja drejtuar kërkuarit është nënshkruar nga babai i tij, kurse kopja që i është dërguar mbrojtësit të caktuar kryesisht është nënshkruar rregullisht personalisht prej tij. Në seancën gjyqësore të datës 29.10.2009 kërkuarit në mungesë i është caktuar kryesisht një përfaqësues ligjor tjetër, i cili ka përgatitur edhe diskutimin përfundimtar.

12. Për sa më sipër, çmoj se duke vlerësuar personat marrës të fletëthirrjeve si persona madhorë si dhe formën e përmbajtjen e tyre, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund ta bënte të pavlefshëm njoftimin në kuptim të neneve 140 dhe 143 të KPP-së. Për rrjedhojë, vlerësoj se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural



penal, si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuarit.

13. Gjithashtu, nga analiza e fakteve të mësipërme, nisur nga deklaratimet e bëra nga babai i kërkuarit, i cili ka nënshkruar të gjitha fletëthirret drejtuar atij, krijohet bindja e ekzistencës së marrëdhënieve të mira midis tyre. Prandaj mendoj se ekzistojnë dyshime të bazuara që kërkuari ka pasur dijeni për procesin penal të zhvilluar në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në gjykimin e çështjes, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të sigurisë juridike, si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 17, datë 19.06.2009; nr. 26, datë 15.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në këtë drejtim, neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ligji organik) ka parashikuar një afat dyvjeçar për paraqitjen e kërkesës përpara kësaj Gjykate.

16. Në rastin në shqyrtim, nga rrethanat e çështjes vërehet se vendimi i fundit objekt kundërshtimi nga kërkuari, vendimi i Gjykatës së Lartë, është i datës 09.05.2012, ndërsa kërkesa e tij drejtuar kësaj Gjykate është e datës 23.05.2014.

17. Nga sa më lart, mendoj se kërkuari ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij dhe me vullnetin e tij të lirë ka hequr dorë nga e drejta e pjesëmarrjes në hetim dhe gjykim. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'iu dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga kërkuari është tej afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar në ligjin organik të kësaj Gjykate. Për rrjedhojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione temporis* për t'iu drejtuar Gjykatës.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 32, datë 25.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare admira babaj, në datën 13.01.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 63/30 akti, që i përket:

KËRKUES: Thoma Lloci

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) Tiranë. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Sarandë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-1662 (324), datë 29.04.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar ZQRPP-së, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe, diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Thoma Lloci ka aplikuar pranë Zyrës Vendore për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Sarandë për të kryer regjistrimin e objektit “Hotel dhe ambiente



shërbimi dhe pishinë”, të ndërtuar në zonën e Kanalit të Cukës, Blloku H-1 në Sarandë, së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës. Origjina e truallit prej 1060 m² mbi të cilin është ndërtuar objekti rrjedh nga kontrata e shitblerjes nr. 1902/584, datë 11.10.1999 lidhur mes Bashkisë Sarandë, në cilësinë e shitësit, dhe shtetasve B.T. dhe F.S., në cilësinë e blerësve. Kërkuesi ka lidhur aktmarrëveshjen nr. 2951/1151/1, datë 05.06.2007 me shtetasin B.T. si pronar i truallit me sipërfaqe 478 m², dhe kontratën e sipërmarrjes nr. 7562/2698/2, datë 18.12.2006 me shtetasin F.S., si pronar i truallit me sipërfaqe 582 m².

2. Kryeregjistruesi i ZQRPP-së Tiranë, me urdhrin nr. 150, datë 03.02.2010, ka refuzuar regjistrimin e objektit të sipërcituar, pasi është konstatuar se kontrata e shitblerjes së truallit nr. 1902/584, datë 11.10.1999 është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 7980, datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve”.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me kërkesë padi me objekt shfuqizimin dhe shpalljen të pavlefshëm të aktit administrativ, urdhrin nr. 150, datë 03.02.2010 të ZQRPP-së Tiranë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. 23-2010-567, datë 06.05.2010, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë; shfuqizimin e aktit administrativ nr. 150, datë 03.02.2009 të ZQRPP-së Tiranë, të dhënë në kundërshtim me ligjin; detyrimin e palës së paditur, ZRPP-së Sarandë të kryejë regjistrimin e objektit “Hotel, ambiente shërbimi dhe pishinë”, të ndërtuar në zonën e Kanalit të Cukës, blloku H-1 në Sarandë, së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës, sipas shkresës nr. 1704 prot, datë 10.12.2009 të Drejtorisë së Urbanistikës së Bashkisë Sarandë”.

5. Mbi ankimin e ZRPP-së Sarandë, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 307, datë 21.09.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 23-2010-567, datë 06.05.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

6. Mbi ankimin e ZQRPP-së Tiranë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2014-1662 (324), datë 29.04.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 23-2010-567, datë 06.05.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të vendimit nr. 307, datë 21.09.2010 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

II

7. **Kërkuesi Thoma Lloci** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës e Lartë. Më konkretisht ai ka parashtruar se:

7.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to.

7.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit në gjykim pasi ka shqyrtuar dhe vendosur për çështjen pa thirrur dhe pa dëgjuar palët e interesuara.

7.3 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka gabuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për pavlefshmërinë e kontratës administrative dhe të veprimit juridik në thelb të çështjes.

7.4 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me qëndrimin lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë ka cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pronën e fituar kohë më parë.

8. **Subjekti i interesuar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) Tiranë**, ka paraqitur prapësime me shkrim duke argumentuar se urdhri nr. 150, datë 03.02.2010 i ZQRPP-së Tiranë është në përputhje me ligjin.

9. **Subjekti i interesuar, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

10. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e ulëta duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ato dhe duke tejkualuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes.

11. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në kuptimin



material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 2, datë 22.01.2014; nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 22, datë 22.07.2009; nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vepron në bazë të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në nenin 58 parashikohet se mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimin; c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit. Bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” Kolegji Administrativ pasi shqyrton çështjen në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore vendos: a) mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 58 i këtij ligji; b) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë; c) prishjen e vendimit të apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit me tjetër trup gjykues.

13. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të

gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.06.2013 dhe nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata Kushtetuese thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen në shqyrtim Gjykata e Lartë është shprehur në përmbajtjen e vendimit të saj se “neni 3 i ligjit nr. 7980, datë 27.07. 1995 “Për shitblerjen e trojeve” ka përcaktuar rastet përjashtimore kur mund të realizohet kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private përpara se të përfundojë procesi i kompensimit fizik të ish-pronarëve. Në rastin objekt gjykimi nuk vërtetohet që paditësi Thoma Lloci të ketë vërtetuar që ndodhet përpara këtyre rasteve përjashtimore dhe për rrjedhojë kontrata e shitblerjes është një veprim absolutisht i pavlefshëm, pasi vjen në kundërshtim me nenin 92/a të Kodit Civil. Për sa i përket kontratës së shitblerjes, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar si një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm, si i tillë nuk sjell asnjë pasojë juridike të dëshiruar prej palëve. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përfundimet e arritura nga gjykatat më të ulëta janë të pabazuara në ligj, pasi në regjistrat e pasurive të paluajtshme regjistrohen vetëm pasuritë e paluajtshme, pronësia e të cilave është fituar në rrugë ligjore dhe jo si në rastin objekt shqyrtimi ku sipërfaqja është tjetërsuar me anë të një veprimi juridik që është kryer në kundërshtim me ligjin, pasi



këto veprime juridike nuk kanë sjellë asnjë pasojë juridike.

15. Nisur nga ky arsyetim, Gjykata Kushtetuese konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër për sa i përket vlerësimit të kontratës së shitblerjes, duke konstatuar jo vetëm kryesisht pavlefshmërinë e kontratës administrative nr. 1902/584, datë 11.10.1999 lidhur mes Këshillit të Bashkisë Sarandë dhe shtetasit F.S., por dhe në kushtet kur nuk rezultojnë të jetë e administruar si provë në dosje.

16. Gjykata Kushtetuese vlerëson se Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, konkretisht nëse paditësi ndodhet apo jo përpara rasteve përjashtimore që parashikojnë ligji, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastër nuk rezultojnë që kjo të jetë vlerësuar. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.06.2013 dhe nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse Kolegji Administrativ ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat më të ulëta, atëherë ai duhet t'i prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Ai në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj (*shih vendimin nr. 36, datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në çështjen konkrete Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkaluar kompetencat ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit është i bazuar dhe duhet pranuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim

18. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pa thirrur dhe pa dëgjuar palët gjatë shqyrtimit të çështjes. Konkretisht, sipas tij, nuk janë thirrur dhe nuk janë dëgjuar nga Gjykata e Lartë as Këshilli i Rrethit Sarandë, në cilësinë e shitësit, dhe as shtetasit F.S. dhe B.T., në cilësinë e blerësit të truallit. Mosthirrja në gjykim e këtyre palëve ka cenuar parimin kontradiktoritetit në gjykim.

19. Kriteri kushtetues i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në pikën 2 të nenit 134 të Kushtetutës, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese, si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori, subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, kërkuari, si subjekt i kushtëzuar, i parashikuar në shkronjën “g” të paragrafit 1 të nenit 134 të Kushtetutës, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij. Pretendimet konkrete që ngre kërkuari kanë të bëjnë me subjekte të cilat nuk janë palë në çështjen e themelit, objekt i vendimit gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Lartë.

20. Për pasojë, Gjykata vlerëson se kërkuarit i mungon interesi vetjak për të ngritur pretendimin konkret, i cili në këto kushte nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

C. Për pretendimin e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të ligjit nga Gjykata e Lartë

21. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka gabuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik (kontratës së shitblerjes), që ka ndikuar drejtpërsëdrejti në marrjen e vendimit nga ana e saj.

22. Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material, apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të



individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 05.02.2014; nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 1, datë 20.01.2012; nr. 23, datë 17.05.2011; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i kërkuarit i parashtruar sa më sipër është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

24. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, se me qëndrimin që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur ndaj fitimit të pronësisë në vendimin që kundërshtohet ka cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pronësinë e pronës private të fituar shumë vite më parë.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk mund të vihet në diskutim (*shih vendimet nr. 24, datë 12.11.2008 dhe nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke vlerësuar pretendimin e kërkuarit dhe bazuar në standardet e mësipërme Gjykata konkludon se argumentet e kërkuarit për cenim të parimit të sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronësisë së fituar nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Në këto kushte Gjykata Kushtetuese çmon se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

27. Në përfundim, në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në çështjen në shqyrtim është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-1662 (324), datë 29.04.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha

VENDIM

Nr. 33, datë 25.5.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare admira babaj, në datën 14.04.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 4 akti që i përket:

KËRKUES: Hamza Hamzai (përfaqësues i trashëgimtarëve ligjorë të Qefser Hamzait)

SUBJEKTE TË INTERSUARA: Fitim Hamzai, Ilirjan Hamzai, Florjan Nuri, Tatjana Nuri, Migena Nuri (trashëgimtarët e Astrit Nurit)

Shoqëria “Labi” sh.p.k., Vlorë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 1302, datë 01.06.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkoji pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarisi, i cili është një nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Qefser Hamzai, në vitin 1993 ka vërtetuar faktin juridik të pronësisë së babait të tij mbi sipërfaqen 8952 m² me vendimin gjyqësor nr. 1733, datë 13.10.1993, duke e regjistruar edhe në Zyrën e Hipotekës në Vlorë në vitin 1994.

2. Kërkuarisi më pas i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP-ja) Vlorë me kërkesë për njohjen pronar të babait të tij mbi sipërfaqen 8952 m², kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 61, datë 29.11.1994 të KKKP-së, që ka vendosur kthimin në natyrë të 8102 m², pasi 850 m² rreth banesës ishin në posedim të tij.

3. Në vitin 2003 kërkuarisi, me pretendimin se vendimi i KKKP-së ishte i paplotë, sepse i mungonte skica, e ka kundërshtuar atë në rrugë gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka caktuar ekspert për të përpiluar planvendodhjen e pronës së kthyer në natyrë, ka vendosur pranimin e padisë dhe plotësimin e vendimit të KKKP-së.

4. Në vitin 2007 subjektet e interesuara kanë vënë në lëvizje paralelisht dy procese: një proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe një proces administrativ përmes denoncimit të paraqitur nga Astrit Nuri, pranë Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit pranë Këshillit të Ministrave, me Faqe| 4760

pretendimin e paligjshmërisë së procedurave të ndjekura për kthimin dhe regjistrimin e pronës nga KKKP-ja Vlorë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesëpadinë e subjekteve të interesuara me objekt *‘Pavërtetësi e faktit juridik të vërtetimit të pronësisë së trashëgimtarëve Qefser Hamzai dhe njohjen pronarë...’*, me vendimin nr. 1120, datë 29.04.2008, ka vendosur pranimin e saj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 404, datë 22.10.2009. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1302, datë 01.06.2012 ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja).

6. Nga ana tjetër, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit pranë KM-së, pas përfundimit të kontrollit administrativ, ka përgatitur një raport kontrolli, ku rekomandonte që AKKP-ja të rishqyrtonte vendimin nr. 61, datë 29.11.1994 të KKKP-së Vlorë, të vendosej kufizimi i regjistrimit mbi pronën, si dhe gjatë rishikimit të vlerësoshin provat bashkëngjitur raportit.

7. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, me vendimin nr. 303, datë 06.08.2007, “Për ushtrimin e së drejtës së iniciativës ndaj vendimeve të dhëna nga ish-KKKP-ja” ka urdhëruar ushtrimin e së drejtës së iniciativës për kontrollin e ligjshmërisë së dosjeve përkatëse. AKKP-ja, me vendimin nr. 562, datë 24.12.2007 “Për njohjen e pronësisë, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës”, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit administrativ për shkak të procesit gjyqësor civil që ishte duke u zhvilluar për të njëjtin objekt.

8. Ndërkohë që kishte përfunduar procesi gjyqësor mbi pavërtetësinë e faktit juridik të pronësisë, AKKP-ja, në zbatim të shkresës nr. 556 prot, datë 11.02.2008 të sekretarit të Përgjithshëm të KM-së, me objekt revokimin e vendimit nr. 562, datë 24.12.2007, ka vendosur *‘Konstatimin e pavlefshmërisë absolute ndaj vendimit nr. 61/1994; mosnjohjen e së drejtës së pronësisë mbi sipërfaqen 8952 m²...’* me vendimin nr. 193, datë 14.06.2010. Po ashtu, AKKP-ja, me vendimin nr. 215, datë 02.07.2010, ka vendosur: *‘T’i njihet pronësia subjektit të shpronësuar Gani Tafili (Hamzai), trashëgimtarëve të tij mbi një pronë truall...dhe t’i kthehet pronësia mbi këtë pronë me sipërfaqe 7852 m²...’*.



9. Kërkuesi i ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore të dyja vendimet e AKKP-së, duke pretenduar se vendimi nr. 193, datë 14.06.2010 i AKKP-së bie ndesh me vendimin nr. 27, datë 27.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesëpadia është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 7035, datë 29.09.2010, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Edhe kërkesëpadia kundër vendimit nr. 215, datë 02.07.2010 të AKKP-së është rrëzuar si e pabazuar në prova dhe në ligj, me vendimin nr. 11198, datë 19.11.2010. Në vitin 2014 kërkuesi është rivendosur në afatin e ankimit kundër vendimit të mësipërm dhe çështja është ende në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

II

10. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 30.05.2014, duke pretenduar mosrespektimin nga Gjykata e Lartë të garancive që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur në kërkesë parashtrohet si vijon:

10.1 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat i kanë mohuar pronësinë mbi pronën pas 15 vjetësh që ajo i ishte njohur e kthyer me vendim të KKKP-së dhe më pas regjistruar në ZRPP Vlorë. Prona objekt gjykimi është poseduar qetësisht mbi 10 vjet, çka do të thotë se trashëgimtarët ligjorë do të ishin bërë pronarë të saj edhe mbi bazën e parashkrimit fitues.

10.2 Është cenuar *e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë*, pasi ndonëse rekursi përmbante shkaqe nga ato që përcakton neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil vendosi mospranimin në dhomë këshillimi.

10.2.1 Kolegji Civil nuk ka marrë parasysh pretendimin për mosrespektimin e kërkesës së ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, që subjekti që pretendon pronën ka qenë subjekt i shpronësuar dhe, si i tillë, ka të drejtë t’i drejtohet KKKP-së. Ndonëse pala paditëse nuk ka paraqitur prova që të vërtetojnë faktin që ishte subjekt i shpronësuar, Kolegji Civil përsëri nuk e mori parasysh këtë paligjshmëri.

10.2.2 Gjithashtu, Kolegji Civil nuk ka marrë parasysh faktin se pala paditëse ka shmangur rrugën ligjore të kundërshtimit të vendimit të KKKP-së, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Padia me objekt pavërtetësinë e faktit juridik të njohjes së pronësisë së Q.H. për 8952 m², vërtetuar me

vendimin nr. 1733, datë 10.10.1993, ishte e pabazuar, pasi si vendim i formës së prerë ai mund të goditej vetëm me kërkesë rishikimi dhe jo përmes ankimit ose rekursit.

10.2.3 Gjykatat në mënyrë të paligjshme kanë cenuar edhe vendimin e KKKP-së, pa pasur padë për anulimin e tij. Vendimi nr. 1120, datë 29.04.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, nga njëra anë pranon pavërtetësinë e pronësisë së Q. H për 8952 m², nga ana tjetër, i njej G.T. pronësinë mbi 4800 m². Edhe kjo parregullsi e procesit, e parashtruar në rekurs, nuk është marrë parasysh nga Kolegji Civil.

10.2.4 AKKP-ja, me vendimin nr. 193, datë 14.06.2010, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KKKP-së Vlorë dhe mosnjohjen e pronësisë me kufizimet përkatëse. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë, proces i cili aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë.

10.2.5 Në rekurs është pasqyruar edhe fakti se ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues nuk u është njoftuar palës që nuk ka qenë pjesëmarrëse në seancë, por përsëri Kolegji Civil nuk e ka marrë parasysh këtë pretendim.

10.3 Është cenuar *standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi, në kundërshtim me nenin 478 të KPC-së, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk pasqyron kërkesën për administrimin e kërkesave shtesë që kanë rëndësi për çështjen dhe as kërkesën për t’i bashkëngjitur rekursit kopjen e vendimit nr. 2459, datë 22.12.2012. Mungesa e këtyre shkaqeve do të thotë se ato jo vetëm nuk janë marrë parasysh, por as janë arsyetuar në marrjen e vendimit.

11. **Subjekti i interesuar, Florian Nuri**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

11.1 Pretendimi në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të gjësë së gjykuar është i pabazuar, sepse në rastin konkret as është cenuar dhe as është ndryshuar asnjë vendim i formës së prerë. Objekti i padisë, në referim të nenit 391 të KPC-së, ka qenë kundërshtimi i i faktit juridik të vërtetuar me vendim gjyqësor në vitin 1993.

11.2 Po ashtu, i pasaktë është edhe pretendimi se vendimi nr. 1733, datë 13.10.1993 mund të kundërshtohet me kërkesë rishikimi, kjo për faktin se ai vendim është pa palë kundërshtare. Referuar paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 391 të KPC-



së, të drejtën e animimit e ka kërkuesi e personat fizikë dhe juridikë që janë thirrur të marrin pjesë në proces.

11.3 Edhe pretendimi se subjektet e interesuara duhet të kundërshtonin vendimin e KKKP-së Vlorë në rrugë administrative është i pabazuar, pasi siç rezulton nga aktet e dosjes, paditësit kanë ndërmarrë njëkohësisht si ankimin administrativ ashtu edhe gjyqësor.

11.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për akses në Gjykatën e Lartë, sepse kërkuesi ka marrë pjesë si palë ndërgjyqëse në gjashtë procese gjyqësore mbi konfliktin e pronësisë, duke pasur mundësi për të paraqitur çdo provë dhe për të debatuar mbi to.

11.5 Në lidhje me kërkesën për bashkimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, ajo është ekstra ligjore dhe pa bazë konkrete në ligjin procedural civil. Kërkesat janë regjistruar në kohë të ndryshme dhe kanë objekte të ndryshme.

11.6 I pabazuar është edhe pretendimi për ndryshimin e trupit gjykues, sepse kërkuesi nuk e ka kundërshtuar këtë fakt.

11.7 Edhe pretendimi për mosrespektimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi Kolegji Civil në dhomë këshillimi ka marrë në shqyrtim të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs dhe ka vlerësuar se nuk përfshihen në rastet e nenit 472 të KPC-së.

12. **Subjekti i interesuar, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë**, nuk ka depozituar prapësime, por në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar të dhënat që rezultojnë në lidhje me pasurinë objekt gjykimi, si dhe ka vënë në dispozicion kopje të dokumentacionit në bazë të të cilit është kryer regjistrimi i pasurisë.

III

A. Në lidhje me formimin e trupit gjykues

13. Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të çështjes, gjyqtarët Fatos Lulo dhe Besnik Imeraj kanë paraqitur kërkesë me shkrim, përmes së cilës, në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kanë kërkuar dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, me argumentin se ata kanë marrë pjesë në gjykimin e së njëjtës çështje në Gjykatën e Lartë. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e ka vlerësuar si të bazuar kërkesën dhe ka

vendosur pranimin e saj në përputhje me nenin 36, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për këto arsye çështja është gjykuar nga një trupë e përbërë nga shtatë gjyqtarë.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

14. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk janë respektuar garancitë që burojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke cenuar për rrjedhojë parimin e sigurisë juridike, të drejtën e aksesit dhe standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

15. Gjykata, pasi mori në shqyrtim këto pretendime të kërkuesit, gjatë votimit në lidhje me to nuk arriti shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj për asnjërën prej tyre¹. Në kushtet kur asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit organik, arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuesit duhet të refuzohet. Megjithatë, ajo rithekson se në referim të përcaktimeve të nenit 74, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesi ta riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g”, dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

¹ Votuan për pranimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj e Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Vladimir Kristo, Sokol Berberi e Gani Dizdari.



VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 34, datë 29.5.2015

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare admira babaj, në datën 02.04.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 16 akti, që i përket:

KËRKUES: Berti Malja, Valbona (Malja) Zaja, përfaqësuar nga avokat Ilir Selenica, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Krujë, komuna Bubq Krujë, në mungesë, Flamur Muka, Loreta Muka, në mungesë, Enea Muka, në mungesë, Ardian Muka, në mungesë, Agron Karaj, në mungesë, Lindita Karaj, në mungesë, Zyber Demiri, në mungesë, Emine Demiri, në mungesë, Lindita Muka, në mungesë, Riza Muka, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2014-2325(372), datë 03.06.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 27, 45 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.12.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesuesve, që janë shprehur për pranimin e kërkesës, propësimet e subjektit të interesuar Flamur Muka, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesit janë trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Rexhep Malja, banor i fshatit Budull, komuna Bubq. Me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. 355 të vitit 1992, Komisioni i Ndarjes së Tokës në Fshat ka kaluar në pronësi të Rexhep Maljat një sipërfaqe toke prej 16.920 m², ndër të cilat edhe një parcelë me sipërfaqe 10.350 m² (pasuria nr. 42/18).

2. Në datën 22.02.2001 midis Rexhep Maljat dhe kryetarit të komisionit, kryeplakut, përfaqësuesit të komunës dhe kryetarit të komunës Bubq është mbajtur procesverbal për refuzimin e marrjes në pronësi të ngastrës nr. 42/18 nga ana e Rexhep Maljat.

3. Me vendimin nr. 1, datë 11.04.2002, komuna Bubq ka vendosur t'i kalojë në pronësi zotit Flamur Muka ngastrën nr. 42/18 të lartpërmendur dhe me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. 423, datë 11.04.2002 është bërë kalimi i pronësisë. Sipas të dhënave të ZVRPP-së Krujë mbi këtë pasuri janë kryer më pas transaksione të tjera në favor të subjekteve të interesuara.

4. I ndjeri Rexhep Malja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesëpadi me objekt pavlefshmërinë e aktit administrativ nr. 423, datë 11.04.2002, si dhe të akteve të tjera që rrjedhin prej tij. Ai pretendon se në momentin që ka refuzuar marrjen e tokës në pronësi nuk ka pasur dijeni për ligjet në fuqi dhe se gjithsesi heqja dorë nuk është vlefshme pasi nuk është bërë nga të gjithë anëtarët e familjes bujqësore (që sipas ligjit përfitonin tokën) dhe me akt noterial për secilin.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 483, datë 05.10.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së Rexhep Maljat si të pabazuar në ligj dhe në prova.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e Rexhep Maljat, me vendimin nr. 1943, datë



18.07.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe pranimit të padisë.

7. Pas dhënies së vendimit të Gjykatës së Apelit, nga dokumentet e depozituara nga kërkuesit, konstatohet se në datën 06.05.2013 ka ndërruar jetë paditësi Rexhep Malja.

8. Në datën 24.09.2013, me vendimin nr. 1246 Rep. dhe nr. 618 Kol. është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore të të ndjerit Rexhep Malja, dhe ndër trashëgimtarët e radhës së parë janë edhe kërkuesit.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2325, datë 03.06.2014 në dhomë këshillimi, mbi rekursin e subjektit të interesuar Flamur Muka, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1943, datë 18.07.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 483, datë 05.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Në këtë vendim si palë ndërgjyqëse rezultoi i ndjeri Rexhep Malja.

II

10. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”), duke pretenduar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Ata kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

10.1. Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e pronës së kërkuesve, pa një proces të rregullt ligjor, pasi Gjykata e Lartë, edhe pse ishte në dijeni të faktit që paditësi kishte ndërruar jetë, nuk ka bërë kalimin procedural sipas nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile (KPC-ja).

10.2. Relacioni i paraqitur në Gjykatë të Lartë prej ndihmësit ligjor nuk është i nënshkruar.

10.3. Arsytimi i vendimit të Gjykatës së Lartë është në kundërshtim me ligjin, pasi kjo e fundit nuk ka marrë parasysh disponimet e nenit 191 të Kodit Civil (KC-ja).

11. **Subjekti i interesuar**, Flamur Muka, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

11.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi nuk mund të kryente kalimin procedural, pasi gjykimi, konform nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, është bërë pa praninë e palëve, vetëm mbi bazën e dokumenteve.

11.2. Mungesa e nënshkrimit prej ndihmësit ligjor të relacionit përkatës, nuk ndikon në ligjshmërinë e procesit, sepse ky akt nuk është pjesë e vendimmarrjes.

11.3. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmbush standardin e arsyetimit të vendimit, sepse përmban shkaqet që motivojnë prishjen e vendimit të apelit. Gjithashtu, ky vendim bazohet në provat e depozituara dhe ka respektuar ligjin material e procedural.

12. **Subjekti i interesuar**, ZVRPP-ja Krujë, me shkresën nr. 365/1 prot., datë 03.03.2015, informon se nga të dhënat e regjistrave rezultoi se në emër të shtetasit Rexhep Malja figuronte e regjistruar pasuria nr. 390/18, vol. 7, fq. 23, arë me sipërfaqe 9100 m², e cila në vitin 2002 i ka kaluar në pronësi shtetit dhe më pas ka kaluar në emër të shtetasit Flamur Muka, i cili ka kryer disa transaksione në favor të të tretëve.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

13. Në analizën e pretendimeve të kërkuesve, Gjykata rithekson se vlerësimi i saj përqendrohet vetëm në ato pretendime që kanë të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që u ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese. Në këtë drejtim Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve se relacioni i ndihmësit ligjor nuk është i nënshkruar, nuk hyn në juridiksionin kushtetues, përderisa kërkuesit nuk kanë përcaktuar se cilat parime kushtetuese që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor janë cenuar si rezultat i kësaj shkeljeje. Për pasojë, në vijim, Gjykata vlerëson të ndalet në pretendimin për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim, si dhe në pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

A. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim

14. Kërkuesit pretendojnë se Gjykata e Lartë u ka cenuar të drejtën e pronës pa një proces të rregullt ligjor, pasi nuk ka bërë kalimin procedural sipas nenit 199 të KPC-së, edhe pse ishte në dijeni të faktit që paditësi kishte ndërruar jetë.

15. Subjekti i interesuar, Flamur Muka, prapëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi nuk mund të kryente kalimin procedural, pasi gjykimi, konform nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, është bërë pa praninë e palëve, vetëm mbi bazën e dokumenteve.



16. Gjykata në jurisprudencën e saj konstante ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Pra, e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, u paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 31, datë 26.05.2014; nr. 18, datë 23.04.2013; nr. 34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këtë aspekt në jurisprudencën kushtetuese e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk është konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, përkundrazi duhet që gjykata gjatë gjykimit t'u japë mundësi të barabarta palëve, në përputhje me legjislacionin procedural, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Edhe parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, është një evolucion logjik i së drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 31, datë 26.05.2014; nr. 18, datë 23.04.2013; nr. 34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e

palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 31, datë 26.05.2014; nr. 18, datë 23.04.2013; nr. 34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se pas paraqitjes së rekursit nga ana e subjektit të interesuar Flamur Muka dhe kundërrekursit nga ana e të ndjerit Rexhep Malja, ky i fundit në datën 06.05.2013 ka ndërruar jetë. Në datën 24.09.2013 është bërë lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore. Në datën 04.03.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në datën 25.03.2014. Kjo seancë është shtyrë për në datën 03.06.2014 për moskonfirmim të njoftimit të palëve ndërgjyqëse. Rezulton, gjithashtu, se fletëthirrja për seancën e datës 03.06.2014 në adresë të Rexhep Maljat është nënshkruar nga avokat Ilir Selenica, i cili shkruan: *"Mora dijeni. Rexhep Malja ka ndërruar jetë"*.

20. Pavarësisht sa më lart, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në seancën e datës 03.06.2014 shprehet se Rexhep Malja *"ka marrë dijeni rregullisht sipas ligjit"*. Për më tepër, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka si palë paditëse të ndjerin Rexhep Malja. Pra, rezulton se Gjykata e Lartë, edhe pse ka pasur dijeni të faktit që paditësi Rexhep Malja ka ndërruar jetë, nuk ka marrë asnjë masë për të bërë kalimin procedural sipas nenit 199 të KPC-së. Për më tepër, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë (që kishte pranuar padinë e trashëgimlënësit të kërkuesve) dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë (që kishte rrëzuar padinë e trashëgimlënësit të kërkuesve).

21. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate moskrijimi i drejtë i ndërgjyqësisë është cilësuar si shkelje e standardeve për një proces të rregullt ligjor dhe është analizuar në drejtim të shkeljes së parimit të kontradiktoritetit në gjykim, si edhe në atë të barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 14, datë 15.04.2003 dhe nr. 13, datë 18.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë duhet analizuar në aspektin e lidhjes së drejtpërdrejtë që ka ekzistenca e shkeljes ligjore me



vetë kërkuesin, si dhe të ndikimit që kjo shkelje mund të ketë sjellë mbi ecurinë e procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 13, datë 18.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata vlerëson se nisur nga kompetencat që ka Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e çështjes edhe në dhomë këshillimi, si dhe bazuar në vendimmarrjen e tij në rastin objekt shqyrtimi (rrezimin e kërkesëpadisë të trashëgimlënësit të kërkuesve), ky Kolegj duke mos respektuar detyrimet që burojnë nga neni 199 i KPC-së për kalimin procedural, ka cenuar të drejtën e kërkuesve për të marrë pjesë në gjykim dhe si pasojë ka cenuar edhe parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve. Prandaj Gjykata arrin në përfundimin se ky pretendim i kërkuesve është i bazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuesit pretendojnë se Gjykata e Lartë ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material, duke e njohur subjektin e interesuar si pronar të truallit. Sipas kërkuesve refuzimi i marrjes në pronësi të pronës në fjalë nuk është bërë konform nenit 191 të KC-së, pasi nuk është hequr dorë prej saj nga të gjithë anëtarët e familjes bujqësore, që kanë përfituar sipas legjislacionit në fuqi, dhe me akt noterial për secilin.

24. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të cilat nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjithashtu, Gjykata për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur

janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.07.2005 dhe nr. 22, datë 06.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesve ka të bëjë me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe nuk lidhet me cenimin e ndonjë të drejte të procesit të rregullt ligjor, për rrjedhojë nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim është i bazuar dhe se kërkesa e tyre lidhur me këtë pretendim duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-2325(372), datë 03.06.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtar kundër: Sokol Berberi



VENDIM
Nr. 36, datë 1.6.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare gjyqësore edmira babaj në datën 27.01.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 58, 61 / 26 akti, që i përket:

KËRKUES: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuar në gjykim nga zonja Marsida Xhaferllari dhe zoti Vildan Kaloshi.

SUBJEKT I INTERESUAR: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga zoti Alban Brati.

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj”; shfuqizimi i vendimit të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e raportit të komisionit hetimor të ngritur me vendimin nr. 70/2014 Për hetimin e kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi”; shfuqizimi i vendimit të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj”.

Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të tri vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të datës 23.10.2014, të kundërshtuara për konflikt kompetencash kushtetuese, deri në hyrjen në fuqi

të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për këtë kërkesë.

BAZA LIGJORE: Neni 134/1, shkronja “ç”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 56 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasì dëgjoì relatorin e çështjes Besnik Imeraj, përfaqësuesit e kërkuetit, që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë në datën 02.09.2014 ka miratuar vendimin nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa dhe zotit Lulzim Lelçaj”. Ky komision u ngrit për shqyrtimin e kërkesës së 39 deputetëve të mazhorancës “Për shkarkimin nga detyra të dy anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, Elvis Çefa dhe Lulzim Lelçaj, për shkelje të rëndë të ligjit, bazuar në nenin 114 të Rregullores së Kuvendit”. Ky vendim i Kuvendit ka hyrë në fuqi në datën 18.09.2014, duke pasur në objekt të tij “...të verifikojë dhe të hetojë zbatimin e ligjit mbi të dhënat, faktet dhe rrethanat e pretenduara, si dhe të konkludojë nëse ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e zotit Elvis Çefa dhe zotit Lulzim Lelçaj nga detyra e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Kuvendi”.

2. Në datën 23.10.2014 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka bërë miratimin e raportit të komisionit hetimor të ngritur me vendimin nr. 70/2014. Në datën 23.10.2014 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka vendosur “Shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së Elvis Çefa dhe shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së Lulzim Lelçaj”.

3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 127, datë 06.10.2014, ka arritur në përfundimin se vendimi i Kuvendit të Shqipërisë nuk përmban shkaqe për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së të parashikuara nga Kushtetuta, por bazohet në një shkak të ri të shtuar me ligjin nr. 101/2014, i cili është kundërshtuar tashmë në Gjykatën Kushtetuese.



4. Gjykata Kushtetuese e mbledhur në datë 24.11.2014 mori në shqyrtim paraprak kërkesën e KLD-së me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, shfuqizimin e vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe pezullimin e këtij vendimi si dhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për shkarkimin nga detyra të dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa dhe zotit Lulzim Lelçaj. Pasi shqyrtoi këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka konstatuar se kërkesat e paraqitura përmbajnë të njëjtin shkak dhe bazë ligjore, për këtë arsye vendosi të bëjë bashkimin e çështjeve me nr. K-14 të Regjistrat Themeltar dhe me nr. K-16 të Regjistrat Themeltar në një proces gjyqësor.

II

5. **Kërkuesi** pretendon se vendimi nr. 70/2014 i Kuvendit të Republikës Shqipërisë objekt kundërshtimi ka krijuar një konflikt kompetence ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, duke parashtruar sa më poshtë:

5.1 Kuvendi ka marrë atributë që u përkasin organeve të tjera kushtetuese, siç janë KLD-ja dhe gjykata, duke u cenuar kështu parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

5.2 KLD-ja është organ kolegjal dhe çështjet e ngritura në kërkesë nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e anëtarëve të veçantë të KLD-së, por me vlerësimin e vendimarrjeve konkrete të saj për çështje konkrete.

5.3 Natyra e mandatit 5-vjeçar të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi tejkalon mandatin 4-vjeçar të Kuvendit që e ka zgjedhur.

5.4 Nisma për ndërprerjen e parakohshme të mandatit me anë të shkarkimit, është një nismë që nuk parashikohet në Kushtetutë, e rrjedhimisht është antikushtetuese.

5.5 Është cenuar parimi i sigurisë juridike. Komisioni hetimor për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së bazohet në ligjin nr. 101/2014, i cili ka hyrë në fuqi në datën 16 shtator 2014 dhe që është kundërshtuar nga KLD-ja në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë mënyrë i jepet fuqi prapavepruese ligjit nr. 101/2014 për fakte që kanë ndodhur përpara datës 16 shtator 2014.

5.6 Zbatimi i këtij vendimi mund të sjellë pasoja në standardet kushtetuese dhe mospezullimi i tij do

të sillte vështirësi në ndreqjen dhe recuperimin e veprimeve pas një vendimi eventual të Gjykatës që do ta shfuqizonte.

6. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në prapësimet e tij parashtron sa më poshtë:

6.1 Mungon legjitimiteti procedural i KLD-së për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet kërkesave objekt gjykimi.

6.2 Ligji i ri nr. 101/2014 është publikuar në Fletoren Zyrtare të datës 01.09.2014 dhe ka hyrë në fuqi në datën 16.09.2014, pra përpara datave që mbajnë dy vendimet e KLD-së.

6.3 Nuk mund të konsiderohet se ka një vendimarrje, në kushtet kur në veprimtarinë e një organi kolegjal, sikundër është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk është thirrur një mbledhje, nuk ka pasur një rend dite, nuk ka pasur një procesverbal, si dhe nuk ka pasur mundësi që të gjithë anëtarët të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë në lidhje me këtë vendimarrje.

6.4 Mungon legjitimiteti substancial i KLD-së për t'i kërkuar Gjykatës Kushtetuese zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, si edhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi.

6.5 Anëtarët e KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi duhet të shkarkohen nëse gjatë ushtrimit të mandatit të tyre shkelin Kushtetutën dhe ligjin.

6.6 Shqyrtimi i ligjshmërisë dhe themelësisë së vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi është një çështje që i takon juridiksionit të pushtetit gjyqësor.

6.7 Kuvendi, në marrjen e vendimeve të tij për shkarkimin nga detyra të dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, u ka atribuuar vetëm fakte që buronin prej detyrimeve ligjore që ishin në fuqi, në kohën kur ata ushtronin funksionet e tyre publike. Rrjedhimisht, ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar edhe në themelin e tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

7. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka pretenduar se KLD-së i mungon legjitimiteti substancial për t'i kërkuar Gjykatës Kushtetuese zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave



ndërmjet pushteteve, si edhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi.

8. Sipas kërkesit, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, cenimi i kompetencave krijon interesin e ligjshëm kushtetues për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë në bazë të nenit 131/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

9. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate, zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve është trajtuar në disa vendime. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin e saj se dispozita e shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore, por edhe ato që mund të lindin ndërmjet organesh ose subjektsh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike, në secilin prej këtyre pushteteve.

10. Gjykata ripohon qëndrimin e saj se që të lindë një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë këto kushte të nevojshme: mosmarrëveshja, si rregull, të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme; mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve kompetente që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin; mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave të përcaktuara nga normat kushtetuese për pushtete të ndryshme, (*shih vendimet nr. 26/2006, nr. 29/2006, nr. 20/2007; nr. 54, datë 05.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin në shqyrtim Kuvendi ka marrë vendimin nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, vendimet e datës 23.10.2014, që lidhen me miratimin e këtij raporti, si dhe me shkarkimet e dy anëtarëve të KLD-së, me të cilat e ka konsideruar veten kompetent për të kontrolluar e vlerësuar veprimtarinë e organit të KLD-së. KLD-ja ka pretenduar se kjo është sferë e kompetencave të saj dhe ka kërkuar zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje në Gjykatën Kushtetuese.

12. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se KLD-ja, si organ kushtetues që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë, konsiderohet e legjitimuar për të qenë palë në një mosmarrëveshje pushtetesh.

13. Kuvendi pretendon se KLD-ja nuk

legjitimohej proceduralisht për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi vendimi nuk ishte firmosur nga të gjithë anëtarët dhe është bazuar në një vendim qarkullues.

14. Gjykata Kushtetuese vlerëson se KLD-ja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, përderisa kërkesa është firmosur në mënyrë të rregullt nga Presidenti i Republikës, që është njëkohësisht edhe Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Për këtë arsye, Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e Kuvendit të Shqipërisë.²

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 70/2014 dhe tri vendimeve të Kuvendit të datës 23.10.2014

15. Kërkuesi ka kërkuar pezullimin e zbatimit të vendimeve objekt shqyrtimi, me pretendimin se zbatimi i këtyre vendimeve mund të sjellë pasoja në parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke pasuar më tej me cenimin e interesave shtetërore e deri te cenimi i interesave të individëve, si dhe me mirëfunksionimin e KLD-së.

16. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e zhvilluar në datat 05.11.2014 dhe 24.11.2014, ka marrë në shqyrtim kërkesat për pezullimin e këtyre vendimeve në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Sipas nenit 45 të ligjit të mësipërm, subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë prekjën e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vëren se nuk shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 dhe për këtë arsye vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim.

17. Gjithashtu, dy ish-anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Elvis Çefa dhe Lulzim Lelçaj, kanë paraqitur kërkesë për të marrë pjesë në cilësinë e subjektit të interesuar në gjykim, meqenëse ka lidhje të drejtpërdrejta me interesat e tyre dhe, sipas tyre, argumente që ata do të paraqesin ndihmojnë në procesin e gjykimit, meqenëse kanë qenë anëtarë të KLD-së dhe

² Gjyqtarët S. Berberi dhe F. Hoxha votuan për moslegjitimimin e kërkesit në aspektin procedural, për arsye se nuk ka një vendimarrje të KLD-së, për të iniciuar gjykimin kushtetues, në përputhje me kriteret ligjore.



vendimi është marrë në kohën kur ata kanë ushtruar detyrën e anëtarit.

18. Para fillimit të seancës, Gjykata, lidhur me kërkesën e paraqitur, vendosi mospranimin e kërkesës së zotit Lulzim Lelçaj dhe zotit Elvis Cefa për të marrë pjesë si subjekte të interesuara në këtë proces, pasi çështja që shqyrtohet është konflikt kompetencash ndërmjet dy institucioneve, prandaj nuk legjitimohen si subjekte të interesuara në këtë proces.

C. Në lidhje me pretendimin për mosmarrëveshjen e kompetencës

19. Kërkuesi pretendon se veprimtaria e komisionit hetimor parlamentar, e materializuar në raportin e tij, miratuar nga Kuvendi me vendimin e datës 23.10.2014, përbën një tejkalim kushtetues të funksioneve të Kuvendit në shkelje të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sepse ka ndërhyrë në kompetencat kushtetuese të organeve të tjera kushtetuese, respektivisht të KLD-së dhe të gjykatave, duke passjellë mosmarrëveshjen e kompetencave.

20. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuesi nuk është në gjendje të evidentojë kompetencën kushtetuese që i është marrë nga Kuvendi i Shqipërisë.

21. Një mosmarrëveshje kompetence, që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese, duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar të papajtueshëm me Kushtetutën shkaku vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes.

22. Gjykata konstaton se në ato raste kur Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim kërkesa për mosmarrëveshje kompetencash, ajo ka vlerësuar të nevojshme të analizojë kuptimin e standardeve kushtetuese, si edhe pozitën kushtetuese në strukturën institucionale shtetërore të organit që pretendon mosmarrëveshjen, duke u ndalur veçanërisht në kompetencat kushtetuese e ligjore të atij organi, si dhe në ballafaqimin e këtyre kompetencave me ato të organit që pretendohet se ka marrë kompetencën, duke shkaktuar, për rrjedhojë, lindjen e mosmarrëveshjes.

23. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Ky parim do të thotë se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur, dhe duhet të ketë një balancë midis tyre. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket ky institucion, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, si dhe nga raportet e kompetencave të tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Kushtetuta në nenin 147 parashikon se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, përgjegjësinë disiplinore sipas ligjit dhe shkarkimin e tyre. Nga ana tjetër, ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se KLD-ja është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të gjykatave të apelit (neni 1). KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e saj (neni 18).

25. Detyrat e KLD-së konkretisht përfshijnë: a) I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve. ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve. dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit, si dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre. e) Emëron dhe shkarkon kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. ë) Emëron dhe shkarkon inspektorët e



Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

26. Jurisprudenca kushtetuese e ka përkufizuar KLD-në si organin kushtetues të pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, KLD-ja përbëhet në shumicën e saj nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Frymën e korporatës (vetëqeverisjes) në KLD, kushtetutëbërësi e ka futur me qëllim të caktuar për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit (*shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Sipas jurisprudencës kushtetuese, mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit “normativ”, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit “individual”, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimin nr. 4 datë 02.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se në cilat kompetenca të tij është cenuar apo është penguar të ushtrojë funksionin e tij si pasojë e miratimit të vendimeve objekt shqyrtimi. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi”, si dhe

vendimet e datës 23.10.2014, që lidhen me miratimin e këtij raporti dhe me shkarkimet e dy anëtarëve të KLD-së, kanë cenuar kompetencat e KLD-së dhe gjykatave, por nuk ka arritur të provojë se në ç’mënyrë dhe në çfarë cilësie vetë kërkuesi i ushtron të tilla kompetenca. Vetë kërkuesi nuk rezulton që të jetë kompetent për çështje që lidhen me shkarkimin dhe emërimin e anëtarëve të KLD-së. Në bazë të nenit 147 të Kushtetutës, KLD-ja është kompetente për transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, ku përfshihet edhe shkarkimi i tyre. Pra, vetëm në lidhje me këto çështje KLD-ja konsiderohet se deklaron përfundimisht vullnetin e pushtetit gjyqësor.

29. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash, pasi nuk ekziston mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit.

Ç. Në lidhje me pretendimin e shfuqizimit të vendimeve të datës 23.10.2014 për shkarkimin e dy anëtarëve të KLD-së

30. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet nr.79, datë 23.10.2014 “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa” dhe nr. 80, datë 23.10.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, zotit Lulzim Lelçaj” janë antikushtetuese dhe kanë krijuar një konflikt me kompetencat.

31. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka parashtruar se shqyrtimi i ligjshmërisë dhe themelësisë së vendimeve të Kuvendit për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi është një çështje që i takon juridiksionit të pushtetit gjyqësor.

32. Gjykata çmon se neni 131/c i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata thekson se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor.



33. Duke analizuar vendimin nr. 79 të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Cefa dhe vendimin nr. 80 të datës 23.10.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Lulzim Lelçaj”, Gjykata çmon se *strictu sensu* këto vendime u drejtohen palëve (dy anëtarëve të KLD-së) si subjekte individualisht të përcaktuara. Gjithashtu, objekti i vendimit është konkret. Efekti i këtyre vendimeve është shkarkimi i anëtarëve të KLD-së, duke u dhënë këtyre vendimeve përmbajtjen e akteve me karakter individual.

34. Gjykata vlerëson se, pasi ka ardhur në përfundim se në çështjen që shqyrtohet nuk ka konflikt kompetencash ndërmjet dy institucioneve, bazuar në konsideratat e mësipërme, kërkuesi, KLD-ja, për këtë pjesë të kërimit (*ratione materiae*) nuk legjitimohet.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e paraqitura nga KLD-ja janë të pabazuara dhe si të tilla duhet të rrëzohen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç”, si dhe të neneve 54, 55, 56, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD-ja), ndonëse ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, nuk pajtohemi me linjën e arsytimit të bërë prej saj, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit.

2. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së

Shqipërisë, ka pretenduar, ndër të tjera, se kërkuar i mungon legjitimitimi procedural për t’iu drejtuar Gjykatës dhe substancial për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave (*shih § 7 dhe 13 të vendimit*). Sipas tij në rastin konkret nuk mund të konsiderohet se ka një vendimmarrje, në kushtet kur në veprimtarinë e një organi kolegjal, sikundër është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk është thirrur një mbledhje, nuk ka pasur një rend dite, nuk ka pasur një procesverbal, si dhe nuk ka pasur mundësi që të gjithë anëtarët të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë në lidhje me këtë vendimmarrje (*shih § 6.3 të vendimit*).

3. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 134 të Kushtetutës rezultojnë se KLD-ja nuk është përfshirë në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për iniciimin e gjykimit kushtetues. Bazuar në nenin 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror - qeverisje vendore). Ashtu siç është shprehur edhe shumica, dispozita e nenit 131/ç të Kushtetutës përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore, por edhe ato që mund të lindin ndërmjet organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të përcaktuar e kategorike në secilin prej këtyre pushteteve.

4. Kjo dispozitë kushtetuese është detajuar në nenin 54 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti (pika 3) dhe se bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve përbën çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore që ka çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (pika 4). Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata vendos, sipas nenit 56 të po këtij ligji, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton edhe



kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit (*shih vendimin nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në këtë kuptim vlerësojmë se KLD-ja, duke qenë njëri prej subjekteve në konflikt që pretendon ndërhyrjen nga ana e pushtetit ligjvënës në sferën e kompetencave që i përkasin ekskluzivisht atij, legjitimohet si subjekt për të iniciuar këtë gjykim kushtetues.

6. Çështja që shtrohet për diskutim dhe në të cilën nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, ka të bëjë me legjitimitimin formal në aspektin e tij procedural, për sa kohë që kërkesa është paraqitur në Gjykatë e nënshkruar vetëm nga Presidenti i Republikës, në bazë të një vendimi qarkullues të miratuar nga Kryetari dhe të firmosur nga 8 anëtarë të KLD-së. Shumica për këtë çështje është mjaftuar me vlerësimin se KLD-ja legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, përderisa kërkesa është firmosur në mënyrë të rregullt nga Presidenti i Republikës, që është njëkohësisht edhe Kryetari i KLD-së (*shih § 14 të vendimit*).

7. Në bazë të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Presidenti i Republikës është Kryetari i KLD-së dhe ai thërret dhe drejton mbledhjen e KLD-së dhe kujdeset për zbatimin e ligjit gjatë zhvillimit të mbledhjeve dhe për marrjen e vendimeve (neni 11). Sipas nenit 18 të po këtij ligji, KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e tij. Mbledhja e KLD-së është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 8 anëtarë (neni 23), kurse neni 26 parashikon se KLD-ja i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje.

8. Në komentet e paraqitura përpara Gjykatës kërkuesi ka pretenduar se në disa raste organizimi i mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të jetë i pamundur, për shkak të karakterit kolegjial të organit, dhe në këto raste është vijuar (është bërë praktikë) me procedimin me vendime qarkulluese. Sipas kërkuetit këto vendime, të cilat u dërgohen anëtarëve në pamundësi për të realizuar mbledhjen e këtij organi, në thelb respektojnë çdo procedurë të parashikuar në ligj, me përjashtimin të pranishëm të anëtarit në mbledhjen përkatëse.

9. Në lidhje me vendimet qarkulluese çmujmë se ato janë vendime që nuk parashikohen nga ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 i ndryshuar (ligji organik i

KLD-së). Në rastin konkret nuk rezulton të ketë pasur ndonjë situatë që e bënte të pamundur realizimin e mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim miratimin e propozimit për dërgimin e kërkesës konkrete në Gjykatën Kushtetuese. Ligji organik i KLD-së parashikon se në rastin e mbledhjes së jashtëzakonshme KLD-ja mbledhet brenda 24 orëve³. Rasti në shqyrtim jo vetëm që nuk lidhet me një prej situatave të parashikuara nga ligji organik i KLD-së për thirrjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme, por dhe pamundësia e mbledhjes së organit nuk justifikon miratimin e një vendimi qarkullues.

10. Gjatë seancës gjyqësore kërkuetit iu shtrua pyetja nëse ishin njoftuar të gjithë anëtarët e KLD-së për projektvendimin dhe nëse kishte një shënim në procesverbalin e mbledhjes për të vërtetuar vullnetin e të gjithë anëtarëve. Kërkueti nuk arriti të argumentonte arsyet e pamundësisë së realizimit të mbledhjes, qoftë edhe të jashtëzakonshme, të organit kolegjial, si dhe situatën urgjente që ka çuar në miratimin e vendimit qarkullues në fjalë. Kërkueti u angazhua se do të vendoste në dispozicion informacionin e kërkuar, gjë e cila nuk u realizua.

11. Bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, të ndryshuar, mbledhjet e KLD-së janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 8 anëtarë. Në rastin konkret vendimi qarkullues është firmosur nga 8 anëtarë, duke plotësuar kriterin e kuorumit të nevojshëm për thirrjen e mbledhjes. Megjithatë, kreu i tretë i ligjit organik të KLD-së parashikon edhe rregulla të tjera specifike që duhen ndjekur për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të KLD-së. Konkretisht, njoftimit për thirrjen e mbledhjes së Këshillit i bashkëlidhet rendi i ditës dhe materialet e çështjeve për të cilat do të diskutohet në mbledhje (neni 20). Rendi i ditës u shpërndahet anëtarëve të KLD-së së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes (22). KLD-ja i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në mbledhje (neni 26). Në procesverbal pasqyrohet data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, rendi i ditës, çështjet që janë diskutuar, diskutimet e pjesëmarrësve, propozimet e bëra, vendimet e marra, forma, rezultati dhe

³ Neni 21 i ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.



mënyra e votimit nga çdo anëtar (neni 27). Rregullat e parashikuara nga ligji organik për KLD-në janë në harmoni edhe me ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të adminis-tratës shtetërore dhe enteve publike”. Në bazë të këtij ligji, në procesverbalin e mbledhjes së organit kolegjial shënohet fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga ky organ.

12. Në vështrim të këtyre dispozitave çmojmë se edhe në kushtet kur nuk ka një mbledhje formale duhet të plotësohen dy elemente, në mënyrë që të kemi një vendimmarrje legjitime të KLD-së: së pari, duhet që anëtarët të kenë mundësi të njoftohen dhe të njihen me çështjen që shtrohet për diskutim dhe, së dyti, të kenë mundësi të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me çështjen e shtruar për vendimmarrje. Respektimi i këtyre dy elementeve është i domosdoshëm, pasi kemi të bëjmë me vendimmarrjen e një organi që funksionon në mënyrë kolegjiale.

13. Në rastin në shqyrtim vlerësojmë se nuk është respektuar procedura ligjore për thirrjen e mbledhjes së KLD-së dhe miratimin e vendimit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave. Për pasojë, në kushtet kur nuk është respektuar procedura për thirrjen e mbledhjes, nuk ka pasur një rend dite, nuk ka pasur një procesverbal të zhvillimit të mbledhjes, si dhe nuk ka pasur mundësi që të gjithë anëtarët të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë në lidhje me këtë vendimmarrje, nuk kemi një vendimmarrje të KLD-së.

14. KLD-ja si organ kolegjial në ushtrimin e veprimtarisë së saj është subjekt i kufizimeve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin organik të saj. Këto kufizime, të cilat janë në funksion të shtetit të së drejtës, mund të jenë të karakterit procedural ose substancial. Rregullimet kushtetuese dhe ligjore për procedurat vendimmarrëse të KLD-së dhe për shumicat e votave të kërkuara, i shërbejnë veçanërisht këtij qëllimi. Në vlerësimin tonë, ndjekja e praktikës procedurale me vendime qarkulluese nga ana e KLD-së rezultojnë të mos ketë bazë kushtetuese ose ligjore, ndaj kjo sjellje institucionale e këtij organi kolegjial e kthyer në praktikë bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës).

15. Parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të

gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa i lejon Kushtetutës dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore (*shih vendimet nr. 15, datë 15.04.2010 dhe nr. 14, datë 21.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa më sipër, duke qenë se çështja e legjitimitetit të subjektit, që vë në lëvizje Gjykatën, është një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një gjykimi kushtetues, bazuar në argumentet e mësipërme, vlerësojmë se Gjykata duhet të ishte ndalur në çështjen e legjitimitetit të kërkuarit në aspektin procedural dhe në përfundim duhet të kishte vendosur mospranimin e kërkesës në kushtet kur nuk ka pasur një vendimmarrje nga ana e KLD-së.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

MENDIM I PAKICËS

1. Nuk jam dakord me vendimmarrjen e shumicës për rrëzimin e pretendimeve të kërkuarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD-ja), për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet tij dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), të krijuar për shkak të vendimit nr. 70/2014 të Kuvendit “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj” si dhe të 3 vendimeve të datës 23.10.2014 të Kuvendit “Për miratimin e raportit të komisionit hetimor të ngritur me vendimin nr. 70/2014 “Për hetimin e kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e dy anëtarëve të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi”; “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa”; “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së të zgjedhur nga Kuvendi, z. Lulzim Lelçaj”.

2. Shumica, pasi ka vlerësuar se KLD-ja si organ kushtetues që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë konsiderohet e legjitimuar për të qenë palë në një mosmarrëveshje pushtetesh (shih paragrafin nr. 12 të vendimit), ka arritur në



përfundimin se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se në cilat kompetenca të tij është cenuar apo është penguar të ushtrojë funksionin e tij. Sipas shumicës, kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 70/2014 “Për ngritjen e komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi”, si dhe vendimet e datës 23.10.2014, që lidhen me miratimin e këtij raporti dhe me shkarkimet e dy anëtarëve të KLD-së, kanë cenuar kompetencat e KLD-së dhe të gjykatave, por nuk ka arritur të provojë se në ç`mënyrë dhe në çfarë cilësie vetë kërkuesi i ushtron të tilla kompetenca. Vetë kërkuesi nuk rezulton të jetë kompetent për çështje që lidhen me shkarkimin dhe emërimin e anëtarëve të KLD-së. Në bazë të nenit 147 të Kushtetutës, KLD-ja është kompetente për transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, ku përfshihet edhe shkarkimi i tyre. Pra, vetëm në lidhje me këto çështje KLD-ja konsiderohet se deklaron përfundimisht vullnetin e pushtetit gjyqësor (*shih paragrafin nr. 28 të vendimit*). Në këto kushte, shumica ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, pasi në rastin në shqyrtim nuk ekziston mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet KLD-së dhe Kuvendit (*shih paragrafin nr. 29 të vendimit*).

3. Për sa u përket vendimeve të datës 23.10.2014 të Kuvendit “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Elvis Çefa” dhe “Për shkarkimin nga detyra të anëtarit të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, zotit Lulzim Lelçaj”, shumica ka çmuar se *strictu sensu* këto vendime u drejtohen palëve (dy anëtarëve të KLD-së) si subjekte individualisht të përcaktuara dhe se objekti i vendimit është konkret. Efekti i këtyre vendimeve është shkarkimi i anëtarëve të KLD-së, duke u dhënë këtyre vendimeve përmbajtjen e akteve me karakter individual (*shih paragrafin nr. 33 të vendimit*). Për pasojë, sipas shumicës, kërkuesi, KLD-ja, edhe për këtë pjesë të kërkimit (*ratione materiae*) nuk legjitimohet (*shih paragrafin nr. 34 të vendimit*).

4. Arsyetimi i mësipërm i shumicës përveçse konfuz, bie ndesh me jurisprudencën e kësaj Gjykate. Sipas doktrinës kushtetuese që të kemi konflikt kompetencash midis pushteteve duhet të përmbushen tri kritere:

a) mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme;

b) mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin;

c) mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave.

5. Gjykata e ka elaboruar më tej konceptin e mosmarrëveshjes së kompetencës duke theksuar se mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë mbi këtë bazë aktin individual të zbatimit. Në praktikë një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimet nr. 48, datë 08.11.2011; nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata ka vërejtur, gjithashtu, se konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk e kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon se sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij apo e kanë penguar në ushtrimin e tyre. Pavarësisht nga shprehja ose jo e kundërshtimeve për përkatësinë e pushtetit, mund të konsiderohet se konflikti është i pranueshëm për t'u gjykuar edhe në rast se nga ushtrimi abuziv i pushtetit pakësohet ose pengohet ushtrimi i kompetencave që Kushtetuta ia atribuon subjektit ankues (*shih vendimin nr. 48, datë 08.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Përveç sa më lart, çështja e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave për shkak të ngritjes (ose jo) të komisioneve hetimore nga ana e Kuvendit ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë edhe në raste të tjera, në të cilat ajo në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur parasysh funksionin kushtetues të Kuvendit (nëpërmjet komisioneve hetimore të tij), si dhe pozicionin e subjektit tjetër kushtetues në konflikt, KLD-ja në



rastin në shqyrtim, në strukturën e organeve të shtetit.

8. Gjykata në shqyrtimin e funksionit kushtetues të Kuvendit dhe të rolit të komisionit parlamentar hetimor në këtë drejtim ka marrë parasysh faktin se Kushtetuta nuk i njeh epërsi një pushteti ose organi kushtetues në raport me pushtetet e tjera të shtetit. Demokracia kushtetuese e vendosur me Kushtetutë bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kuvendi është njëri nga organet e autoritetit të shtetit. Kompetencat e tij dhe për pasojë sfera e veprimtarisë së tij është e përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligje. Kuvendi gëzon, brenda limiteve të parashikuara në Kushtetutë, një autonomi të konsiderueshme për vendimet që lidhen me ligjvënien. Brenda kësaj sfere, shkalla e autonomisë së Kuvendit është më e madhe se në sfera të tjera të kompetencave të tij, për shkak të faktit se ai është organi ligjvënës i shtetit. Kushtetuta e ngarkon Kuvendin edhe me funksion kontrollues, me synimin për të realizuar balancën midis pushteteve. Në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. Në këtë kuptim, funksioni i kontrollit parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit ligjvënës për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta. Kjo vlen edhe për komisionet hetimore, objekti i veprimtarisë të së cilave, i përcaktuar në vendimet e ngritjes së tyre, është objekt i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimet nr. 19, datë 03.05.2007; nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Detyra që i ngarkohet një komisioni hetimor parlamentar nuk mund të jetë e tillë që të çojë në shkeljen e rregullimeve kushtetuese që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me organet, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit që ushtron Kuvendi. Kufijtë e veprimtarisë së një komisioni hetimor janë specifikuar nga limitet kushtetuese për kontrollin e Kuvendit. Veprimtaria e një komisioni hetimor nuk duhet as të zëvendësojë, as të marrë kompetencat e organeve të cilat në bazë të Kushtetutës janë të detyruara ta realizojnë këtë kompetencë. Gjykata

është shprehur se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, si parimin e ndarjes së pushteteve, të prezumimit të pafajësisë etj. (*shih vendimet nr. 26, datë 04.12.2006; nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Një hetim i iniciuar, që nuk lidhet me qëllimet dhe që nuk i përket veprimtarisë së ligjvënësit dhe rolit kontrollues brenda kufijve të trajtuar më sipër, nuk konsiderohet në përputhje me parimet kushtetuese. Komisioni hetimor, duke hetuar një fushë të caktuar brenda kompetencave që përfshihen në përgjegjësinë kushtetuese të Kuvendit, mund të arrijë të gjejë të dhëna të cilat përbëjnë shkak për t'u vlerësuar nga ana e tij, por pa hyrë në sferën e organeve hetimore e gjyqësore të ngarkuara nga Kushtetuta për veprimtari të këtij lloji (*shih vendimet nr. 26, datë 04.12.2006; nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se Kuvendi mund të ushtrojë hetim nëpërmjet komisioneve të tij edhe mbi zyrtarët e institucioneve kushtetuese për çështje të veçanta, të cilat përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që lejohen nga Kushtetuta, por një hetim i tillë nuk mund të zëvendësojë apo të dublojë prerogativat e organeve të tjera të pavarura (*shih vendimin nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, Gjykata është shprehur se kur Kuvendi ngre një komision hetimor, duhet të respektojë parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, përndryshe mund të krijohen premisa për lindjen e një konflikti kompetencash.

11. Për sa i përket pozicionit kushtetues të organit të KLD-së, Kushtetuta në nenin 147 parashikon se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, përgjegjësinë disiplinore sipas ligjit dhe shkarkimin e tyre. Nga ana tjetër, ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar parashikon se KLD-ja është autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën dhe kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të gjykatave të apelit (neni 1). KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e saj (neni 18).



12. Detyrat e KLD-së konkretisht përfshijnë: a) I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. b) Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve. ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve. dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit, si dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre. e) Emëron dhe shkarkon kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit. ë) Emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

13. Jurisprudenca kushtetuese e ka përkufizuar KLD-në si organin kushtetues të pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. KLD-ja përbëhet në shumicën e saj nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Frymën e korporatës (vetëqeverisjes) në KLD kushtetutëbërësi e ka futur me qëllim të caktuar për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit (shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Nga sa më lart rezulton se KLD-ja është një organ administrativ i pavarur që realizon vetëqeverisjen e pushtetit gjyqësor. Bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, të ndryshuar, KLD-ja i kryen funksionet që i janë ngarkuar nga Kushtetuta në mënyrë kolegjiale në mbledhjet e tij.

15. Në rastin në shqyrtim objekti i hetimit të komisionit, i cili nuk mund të kuptohet i shkëputur nga çështjet që kanë gjetur pasqyrim në raportin e komisionit hetimor, konsiston: 1. Në shkeljen e standardit kushtetues të paanësisë (shkarkimi i z. Sokol Binaj dhe caktimi i z. Gjin Gjoni, anëtar i KLD-së, si anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, në shkelje të ligjit; emërimi i z. Neshat Fana si drejtor i Shkollës së Magjistraturës në shkelje të ligjit; zgjedhja e anëtarit të KLD-së, z. Ilir Mustafaj, si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë). 2. Në mosverifikimin e papajtuëshmërisë së mandatit të anëtarit të KLD-së. 3. Në

mosemërimin brenda afatit ligjor të magjistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitet 2012, 2013 dhe 2014. 4. Në marrjen nga KLD-ja të kompetencave të Shkollës së Magjistraturës në testimin seleksionues të kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat administrative. 5. Në marrjen nga KLD-ja të kompetencave të Ministrisë të Drejtësisë për shpalljen e vendeve vakantë në gjykata, 6. Në mosemërimin e kryetarëve të 28 gjykatave në kundërshtim me ligjin. 7. Në emërimin e kryetarëve të gjykatave në kundërshtim me ligjin. 8. Në promovimin e gjyqtarëve në kundërshtim me ligjin. 9. Në keqorganizimin e sistemit gjyqësor. 10. Në mosmarrjen në shqyrtim të kërkesave të ish-Kryetares së Gjykatës të Lartë dhe ish-Prokurores së Përgjithshme. 11. Në emërimin e z. Arjan Balliu si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

16. Bazuar në rezultatet e hetimit parlamentar vërehet se edhe pse objekti i këtij hetimi ka pasur si qëllim verifikimin dhe hetimin për zbatimin e ligjit nga ana e dy anëtarëve të KLD-së së zgjedhur nga Kuvendi, komisioni hetimor i ngritur ka marrë në shqyrtim vendimet e KLD-së të marra si organ kolegjial. Pra, veprimtaria e komisionit hetimor nuk është ndalur në veprime apo mosveprime antiligjore apo antikushtetuese të kryera individualisht nga 2 anëtarët e KLD-së, z. Elvis Çefaj dhe z. Lulzim Lelçaj, por në thelb ka vënë në pikëpyetje vendimmarrjen e një organi kolegjial të pavarur, siç është KLD-ja, pjesë e të cilës kanë qenë edhe anëtarët në fjalë, duke cenuar rëndë pavarësinë e këtij organi kushtetues. Për rrjedhojë, komisioni hetimor ka kryer një veprimtari që nuk hyn në sferën e tij të kompetencave, duke krijuar, për rrjedhojë, një konflikt kompetencash midis pushtetit legjislativ dhe atij gjyqësor.

17. Gjykata ka theksuar se hetimi parlamentar, në interpretim të nenit 77 të Kushtetutës, që sanksionon veprimtarinë e komisioneve hetimore të Kuvendit, nuk mund të jetë absolutisht i pakufizuar. Ky kufizim imponon që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, që hetimi parlamentar të lidhet me veprimtarinë e ligjvënësit dhe që hetimi të mos përdoret (si në rastin konkret) në mënyrë abuzive (shih vendimin nr. 12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Si përfundim, në rastin konkret jam i mendimit se kërkesa e KLD-së duhej pranuar.

Anëtar: Vladimir Kristo

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë